



PILOTI LIDHJA E MAJORIT ME 'GRUPIN KOKAINA'



• NË FOTO:
(majtas) Piloti Sokol Feka që u
rrezua me helikopter në Malaga
të Spanjës (lart) Kelmend Dalipi

Kunati i Sokol Fekës është Arben Gishto, që ka qenë dënuar në Itali për trafik droge me "Bandën e Fierit", ku ka bërë pjesë edhe Klemend Dalipi që u kap në laboratorin e kokainës në Xibrakë të Elbasanit me nipin e Enverit

► FAQE 2-3

• LISTA E PLOTE

► FAQE 14-15

Ish-të përndjekurit, 820 emrat e rinj e këstit të 3-të

Ja personat që duhet të plotësojnë dokumentacionin e nevojshëm për të marrë dëmshpërblimet



BARI dhe BRINDISI
nga € 29*
LA COMODITA' CHE CERCAVI

Fluturime direkte nga **Tirana**
çdo të Hënë, të Mërkurë e të Premte

*duke filluar nga € 29 për segment,
taksa e bagazh përfshirë, vende të limituara.

+355 42 251837
për informacione e prenotime

Na ndiqni në f YouTube
www.balkanexpress.it



Vizita, Analiza & Diagnostikim
Të garantuara
sipas protokolleve të
njekësive bashkëkohore
nga Blue Medical Center

Të parandalosh, më mirë se të kurosh!

Adresa: Rruga "Bardhyl" Nr.101, Tiranë
Tel: + 355 4 2370 668

Cel: +355 66 20 90 008
Email: info@bmc.al, www.bmc.al

HUMOR



NGA **ARBEN DUKA**

Shqipëri kështu të desha, plot drejtorë e drejtoresha!

► Ntë faqen 20

BLOG / PERIFERI



NGA **ALBA MALLTEZI**

Z. Berisha, hidhini një sy FB të Gianni Morandit

Ndjek për kënaqësi këngëtarin italian në Facebook, Gianni Morandi, ndjek gjithashtu, për punë, edhe politikanin z.Sali Berisha. Nuk e kisha vënë re se kanë disa të përbashkëta: Kanë të njëjtën moshë, të dy të lindur në vitin 1944, Berisha në tetor, Morandi në dhjetor.

► vijon në faqen 11

KOMENT



NGA **AFRIM KRASNIQI**

Evropa përballë dhe konfliktet rurale

Nëse ndonjëri prej nesh e shkëput veten për dy ditë të vetme nga rutina e ditës shqiptare dhe e imagjinion veten qytetar në Paris, Romë,...

► vijon në faqen 11

» MAJORI

SOKOL FEKA që humbi jetën në Malaga, iu ka treguar familjarëve se do të shkonte në Spanjë dhe do të kthehej të mërkurën, pasi ishte nisur me mision nga puna

Roma e Mynihu, destinacionet e 4 lëvizjeve të major Fekës

Në nëntor, piloti qëndroi jashtë vendi më shumë se 1 muaj

NIKOLETA KOVAČI
TIRANE

Majori i Forcave të Armatosura, piloti i talentuar, djali me një jetë tejet të trazuar, nga fati dhe, me sa duket, edhe nga profesioni, i cili humbi jetën në krahinën e Malagës në Spanjë, atë ditë që është larguar në drejtim të Romës, mësohet se ka dhënë edhe destinacionin e tij të përcaktuar; Spanjën. Ai i ka treguar familjes se do të qëndronte disa ditë në Spanjë, pasi atje e kishte përcaktuar puna të shkente, pasi do të merrej me riparimin e disa helikopterëve dhe se do të qëndronte në Spanjë deri ditën e mërkurë, kur edhe do të kthehej për në Shqipëri. Por, piloti elitë i FA, me talentin e të cilit u mburrën edhe ministria të Mbrojtjes në vendin tonë, humbi jetën teksa drej-

VIDEO/ KATER LEVIZJET E MAJOR FEKES

Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të AIREPORT që shkakohet falas



Majori Sokol Feka

Precedenti
Majori Sokol Feka dyshohet se ka kryer edhe një lëvizje tjetër nga Turqia në drejtim të Shqipërisë ndërsa nuk është e përcaktuar dalja jashtë dhe motivacioni

tonte një helikopter brenda të cilit gjendeshin rreth një ton hashash. Mirëpo, ndonëse Ministria e Mbrojtjes, mohoi faktin se piloti kishte marrë leje të lëvizte jashtë vendi, konfirmoi se piloti me gradën e 'Majorit' ishte me leje të

zakonshme. Sokol Feka, nga sistemi TIMS, rezultoi të ketë kryer katër lëvizje, ndërsa tre prej tyre edhe të motivuara. Në udhëtimin e fundit për vitin 2014, Feka ka qëndruar për më shumë se një muaj jashtë vendi, por që ishte

përcaktuar edhe destinacioni.

LËVIZJET

Majori i ushtrisë shqiptare Sokol Feka i përfshirë në trafikun e drogës me helikopter nga Maroku drejt Spanjës rezultoi të ketë udhëtuar

jashtë Shqipërisë 3 herë të tjera prej vitit 2014. Udhëtimi i fundit që i mori jetën, daton më 20 janar, që i bie të jetë udhëtimi i katërt në harkun kohor të një viti jashtë vendi.

Këto udhëtime janë dokumentuar mësohet se Feka në një nga lëvizjet jashtë vendit, ka deklaruar se shkuar për kurs trajnimi në Gjermani së bashku me disa kolegë dhe 2 herë të tjera për turizëm me qëndrim të shkurtër drejt vendeve të Bashkimit Evropian. Dalja e parë e tij daton më 15 qershor të 2014-ës nga aeroporti i Rinasit drejt Romës për t'u kthyer më 23 korrik 2014 nga Roma në Tiranë. Në daljen e tij të dytë, Feka përdor të njëjtin itinerar. Më 21 shtator 2014 del nga Rinas me destinacion Romën dhe kthehet po nga Roma drejt Tiranës pas 9 ditësh, më 30 shtator. Më 16 nëntor 2014 piloti doli nga Shqipëria me destinacion Mynihun, ndërsa është kthyer më 20 dhjetor nga Roma.

HETIME

Edhe pse prokuroria ende nuk ka nisur hetime në lidhje me ngjarjen e rëndë ku një pilot me gradën major të FA humbi jetën në një helikopter droge në Spanjë, mësohet se ka qenë policia ushtarake që ka nisur verifikimet e të gjitha lëvizjeve të viktimit, bazuar në dokumentacionin që mban reparti i Farkës, repart në të cilin kishte zyrën edhe instruktori i pilotëve. Verifikimet kanë hedhur dritë edhe mbi një lëvizje të dy viteve më parë të Fekës, i cili mësohet se ka hyrë nga Turqia në drejtim të vendit tonë, por nuk është dokumentuar dalja e tij. Sipas të dhënave, saktësohet se prej më shumë se 48 orësh, të gjithë pilotët dhe miqtë ushtarak të viktimit janë nën mbikëqyrje të rreptë, ndërsa janë marrë në pyetje në lidhje me ngjarjen.



Helikopteri i rrëzuar në Spanjë

REAGIMI

"Feka", Ushtria: Nevojë për reformim



Flamur Hadushi

— Kolonel, Flamur Hadushi, komandant i Forcave Ajrore, ka folur dje mbi ngjarjen e rëndë, duke kërkuar që mos të njehsohet FA me rastin: "Ngjarja ku gjeti vdekjen major Sokol Feka është një ngjarje e rëndë, e cila flet për domosdoshmërinë e reformimit të thellë që kemi ndërmarrë në të gjitha nivelet e drejtimit të FA. Është një ngjarje që flet po ashtu për rëndësinë e zbatimit të rregullave dhe procedurave për daljet jashtë vendit të personelit ushtarak, si dhe nevojën që të rrisim më tej integritetin e të gjithë efektiveve tanë. Por, po ashtu, askush nuk ka të drejtën morale të ngrejë gishtin e akuzës ndaj gjithë Forcave të Armatosura dhe efektiveve të saj, për shkak se një pilot i efektiveve tanë u gjet i përfshirë në veprimtari të paligjshme jashtë kufijve të vendit".

Dyshimet
TIRANE

Baza ajrore në Farkë, brenda së cilës gjendej edhe zyra e majorit, që instruktonte pilotët e rinj, është blinduar nga policia ushtarake menjëherë pas marrjes së lajmit të vdekjes me një helikopter droge në Spanjë të Sokol Fekës. Sipas të dhënave, bëhet me dije se është ushtruar kontroll i imtësishëm në repart dhe në bazë, ndërsa mësohet se janë sekuestruar edhe të gjithë regjistrat e punonjësve të kësaj Baze për të mësuar hollësi mbi lëvizjet, lejet dhe lidhjet e tyre me majorin që humbi jetën në Malaga. Njëkohësisht bëhet me dije se përveç se do të kryhen kontroll mbi kontaktet e punonjësve të bazës, kryesisht pilotëve me Fekën, burimet sqarojnë se kontrollit do t'i nënshtrohen edhe adresat e imaleve si dhe komunikimi mes tyre në rrjetet sociale. Ndonëse drejtues të kësaj baze dhe zëra zyrtar nga Ministria e Mbrojtjes kanë mohuar në mënyrë kategorike

Policia ushtarake blindon bazën ajrore, kontroll kolegëve

Hetohen kontaktet elektronike dhe telefonike të pilotëve me Sokol Fekën

të ketë lëvizur ndonjë pilot tjetër jashtë vendi, dyshimet tashmë shtrihen mbi të gjithë ata punonjës, që janë elita e fluturimit për FA-në.

Edhe pse policia ka nisur verifikimet dhe hetimet mbi lidhjet e Fekës me ndonjë element të trafikut ndërkombëtar të drogës, në fakt ka rezultuar se në lidhjet e tij shoqërore, ai nuk është i mpleksur me asnjë person të dyshimtë dhe aq më pak me ndonjë me precedent penal. Feka, kujtohet nga të gjithë shokët e tij, si djali që sfidonte me buzëqeshje problemet ekonomike të vetat, ndërsa, si rrallë kush tjetër, ai merrej me bukë me vete në punë, pasi rroga nuk i dilte as për të paguar detyrimet.




Majori Feka, kujtohet nga të gjithë shokët e tij, si djali që sfidonte me buzëqeshje problemet ekonomike të vetat, ndërsa, si rrallë kush tjetër, merrej me bukë me vete në punë



Kelmend Dalipi

Emri	Mbiemri	Adresa	Data lindja	Vendi lindja	Kryeqytet	Shkollë	Udhëtim	Shkollë	Udhëtim
ALUSH	PEMBE								
SOKOL	FEKA		27/07/1974	BERAT					
GISHTO	ARBEN		26/08/1963	FERIPER					
MIRELA	GISHTO		02/10/1969	VERTOPJERBAT					



Faksimile e ekstraktit të Gjendjen Civile ku tregohet lidhja miqësore mes Sokol Fekës dhe Arben Gishtos

Faksimile e dokumentit që flet për trafikimin dhe shpërndarjen e kokainës në Itali nga Arben Gishto dhe shtetasi Kelmend Dalipi, i kapur në laboratorin e Xibrakës

Hetimet


ELTON QYNO
TIRANE

Lidhjet e pilotit me Bandën e Fierit dhe "Grupin Kokaina"

Krushqja me Arben Gishton e Fierit të proceduar në Itali për kokainë, në grup edhe Kelmend Dalipi

Kërkesa në ministri
Familjarët kërkojnë sjelljen e trupit të Fekës nga Spanja

— Edhe pse të shokuar për ngjarjen e rëndë dhe për rolin kriminal që ka pasur në këtë ngjarje piloti shqiptar, familjarët i kanë kërkuar zyrtarëve të ministrisë së Mbrojtjes dhe asaj të Jashtme të mundësojnë trupin e Sokol Fekës nga Spanja në drejtim të Shqipërisë, në mënyrë që të kryejnë ceremoninë mortore. Prej tre ditësh të afërmit, grua ja dhe fëmijët janë në ankth, pasi qëndrojnë vetëm në dëgjimin e lajmeve dhe hidhërimit, duke mos pasur trupin e të ndjerit. Sipas vjehrrit të majorit Sokol Feka, ky i fundit ka qëndruar disa ditë në Angli për një specializim dhe më pas është larguar në Spanjë, me argumentin se do të rregullonte një helikopter. Vjehrrin




Shtëpia e Sokol Fekës

ka shtuar se nuk kanë pasur asnjë të dhënë se i dhëndri ishte i përfshirë në trafik droge. Sipas tij, Sokol Feka, ka vuajtur mungesën financiare pasi dhe pjesa më e madhe e rrogës i kalonte si pension për dy fëmijët që ka pasur nga martesja e parë.

bëtar droge me helikopter.

KRUSHQJA ME GISHTON
Mësohet se piloti i rregjimentit të helikopterëve në bazën e Farkës, ka kунat shtetasin Arben Gishto, ky i fundit i proceduar penalisht për trafik kokaine në Itali dhe i dënuar me dy vite burg në Shqipëri për mbajtje pa leje të një pistolette tip "Zastava". Burimet pranë SHIU-t, thanë për gazetën se janë duke verifikuar me imtësi të gjitha telefonatat e pilotit. Më tej të njëjtat burime shtuan se Arben Gishto ka marrë për grua një nga motrat e pilotit. Nga një verifikim të kryer në regjistrin e gjendjes civile rezultoi se Mirela Gishto, është gruaja e Arben Gishtos dhe se konstatohet se emrat e babait dhe nënës janë të njëjtë me ata që konstatohet dhe tek të dhënat e pilotit ushtarak.

GISHTO-KELMENDI
Në një dokument të siguruar nga "Shqiptarja.com" rezultoi se kunati i pilotit Sokol Feka, Arben Gishto së bashku me të arrestuarin në laboratorin e kokainës në Xibrakë, Kelmend Dalipi, rezultojnë të kenë qenë pjesë e një grupi që kanë



Sokol Feka

VIDEO/ SPANJE BIE HELIKOPTERI ME DROGE, PILOTI SHQIPTAR

Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të A1REPORT që shkarkohet falas

trafikuar 23 kg kokainë nga Holanda në Itali. Pikërisht në këtë grup ka bërë pjesë dhe një emër i njohur në Fier me inicialet A.I, që sot është biznesmen. Sipas dokumentit në 18 shkurt 2005 shtetasi A.I mbante me qëllim që ta shpërndante 3 kg kokainë, të sjellë nga Holanda dhe ia dorëzonte për transpor-

1 ton
Kjo është sasia e drogës e cila është sekuestruar nga policia Spanjolle pas rrëzimit të helikopterit që drejtohej nga piloti Shqiptar Sokol Feka

tim Andreas Gatsoulis. Më 27 mars 2005 në bashkëpunim me Artur Lika kanë transportuar dhe shpërndarë 5,8 kg drogë e lojit kokainë. Më 20 e 21 prill 2005 në bashkëpunim me Kelmend Dalipi, Fatjon Aliaj mbajnë me qëllim për ta shpërndarë, transportojnë dhe importojnë sasi kokainë prej 2994 gr. Më 25 gusht 2005 në bashkëpunim me Arben Gishto mbanin me qëllim që ta transportonin një personi me emrin Adi i kilogram kokainë. Këto vepra penale në mënyrë të mësipërme janë kryer edhe në bashkëpunim me persona si Erion Dane, për 7 shtatë kilogram kokainë, 2 tetor 2005, në bashkëpunim me Arben Gishto, për 50 gram kokainë, 6 dhjetor 2005, në bashkëpunim me Dritan Leshanaku, më 28 shkurt 2006, etj.

AKUZAT

Majori i FA Basha: Krimi i organizuar ka kapur shtetin

Strazimiri: Rama ka "rilindur" tregun e kokainës dhe krimin

Përfshirja e majorit të Forcave të Armatosura Sokol Feka në trafikun ndërkombëtar të drogës, i cili drejtohej helikopterit me drogë nga Maroku në Spanjë, ka vijuar të jetë një temë e nxehtë për akuzat politike edhe gjatë ditës së djeshme. Duke u referuar rastit në fjalë, kreu demokrat Lulzim Basha ka akuzuar qeverinë si të lidhur ngushtë me krimin dhe bandat e narkotrafikut. Sipas liderit të selisë blu vendi është kthyer në një terren të favorshëm për prodhimin dhe trafikimin e lëndëve narkotike, duke përmendur rastet e fundit të instalimit të impiantit të kokainës, apo përfshirjen e efektivit të FA në trafik ndërkombëtar të narkotikëve. Ndërkohë kreu i Partisë Demokratike vlerësoi se dekriminalizimi është një proces jetik për vendin, e për të ardhmen europiane, pasi çdo ditë po konstatohen raste të emërimit të personave me precedentë të rëndë penalë deri në postet me të larta të qeverisjes. Nga

ana tjetër, edhe deputeti demokrat Gent Strazimiri duke u referuar rrëzimit të avionit me drogë në Spanjë



Gent Strazimiri

Deklarata
"Nëse aksidentalisht, helikopteri i drogës, nuk do të kishte përfunduar në telat e tensionit të lartë në Spanjë, i kthyer "nga pushimet" piloti do të rikthehej "në krye të detyrës" i pashqetësuar, për të transportuar "Sajmirin" e kryeministrit nëpër gërshet e jugut".

dhe përfshirjes së pilotit të Forcave të Armatosura shqiptare në këtë ngjarje, ka akuzuar qeverinë që sipas tij ka

Shqetësimi
Kreu demokrat theksoi dje se vendi është kthyer në një terren të favorshëm për prodhimin dhe trafikimin e lëndëve narkotike, duke përmendur rastet e fundit të instalimit të impiantit të kokainës, apo përfshirjen e efektivit të FA në trafik ndërkombëtar të narkotikëve.

mëshkëtur krimin e organizuar dhe trafikun e drogës. Deputeti Dmeokrat, Gent Strazimiri tha se kjo ngjarje tregon situatën kriminale në Shqipëri dhe se si ajo është kthyer një vend me "ofertë" të pakufizuar për krimin dhe trafikun ndërkombëtar të drogës. "Në Spanjë, aksidentalisht, ka dalë në pah se në çfarë derexheje është katandisur siguria kombëtare, Forcat e Armatosura, Policia Ushtarake, strukturat inteligjente dhe të informacionit të ushtrisë dhe të Policisë së Shtetit, kontrolli i territorit, lufta kundër krimit të organizuar dhe trafikut të narkotikëve. "Rilindja" e strukturave inteligjente të ushtrisë dhe policisë, me ish-punonjës të "shtëpisë me gjethe", operativë të Sigurimit të Shtetit, në këto 498 ditë i ka lidhur sytë, veshët, duart dhe këmbët çdo qelizë të shtetit, duke u lënë dorë të lirë organizatave kriminale nga e gjithë bota të hapin praktikisht "zyrë pune" në Shqipëri", deklaroi deputeti demokrat Gent Strazimiri.

Emërimet në Administratë, Pollo: Zgjerorjmë hetimet

Balla: Kur Basha ishte ministër i Jashtëm, droga lëvizte me makinat e diplomatëve jashtë vendit

JUXHIN MUSTAFARAJ
TIRANË

Kryetari i Komisionit hetimor parlamentar për emërimet në administratë, Genc Pollo kërkoi zgjerim të kohës në të cilin do të bëhen verifikimi i punësime në administratë. Në mbledhjen e parë të komisionit hetimor të kërkuar nga PD që u zhvillua në kryesinë e Kuvendit, Pollo sqaroi se muaj prill i vendosur si afat në të cilin duhen mbyllur hetimet për punësimet në administratë, duhet shtyrë pasi PD ka denoncuar raste edhe pas këtij muaji. "Fakti që disa dyzina u provuan nga opozita në konferenca për shtyp ngjalli një shqetësim të madh në opinion. Kjo nuk mund të lihet vetëm me denoncim publik nga opozita dhe heshtje nga qeveria", tha Pollo. Ndërkohë që nënkryetari i këtij Komisioni, Taulant Balla, theksoi se më shumë sesa zgjatja në kohë e hetimeve është e nevojshme që në hetim të përfshihen edhe punësimet në bashkitë e drejtuara nga e djatha pas zgjedhjeve të 23 qershorit. "Maxhoranca ngriti komisionin për të vërtetuar atë mbi të cilin ju keni hedhur balte gjithë këto muaj për administratën publike. Kemi mjaft prova konkrete që elemente kriminale të larguar nga administrata strehohen sot në Bashkinë e Tiranës, në ndërmarrjen e ujësjellësit, në bashkinë Kamëz, Mamurras, Shkodër, Vorë, Paskuqan, në Petrelë, Bërzhitë, Farkë, Kashar, Roskovec", deklaroi Balla. Nënkryetari i komisionit i shtriu akoma më tej në kohë pretendimet, kur akuzoi kreun aktual të Bashkisë së Tiranës, Lulzim Basha. Sipas nënkryetarit të grupit të PS-së Balla, gjatë kohës kur Basha ishte ministër i Jashtëm në makinat e diplomatëve qarkullohej drogë. "Kur Basha ishte ministër i Jashtëm transportohej drogë me makinat e ambasadave shqiptare", deklaroi Balla, i cili theksoi se këto akuzat do



Komisioni Hetimor

Akuza
Kur Lulzim Basha ishte ministër i Jashtëm transportohej drogë me makinat e ambasadave shqiptare nëpër botë

t'i dokumentoj me shkrim. Komisioni ka si qëllim të hetojë ligjshmërinë e hetimeve nga data 15 shtator 2013 deri në 31 maj 2014, por edhe për këtë kryetari Pollo propozoi zgjatje të kohës pasi sipas

tij në administratë janë emëruar elementë kriminale edhe pas datës 31 maj.

TATIMET

Dje është zhvilluar edhe mbledhja e parë e komisionit hetimor për serverin e Tatimeve i drejtuar nga Arben Ristani. Në mbledhjen e djeshme është miratuar rregullorja e punës. Nënkryetari i mazhorancës Blendi Klosi, gjatë mbledhjes deklaroi se historia është e vështirë

PRECEDENTI

Nishani: Rasti i majorit të FA, përgjegjësi e mazhorancës



— Kreu i shtetit ka deklaruar gjatë ditës së djeshme se rasti i majorit të Forcave të Armatosura, i cili ishte i përfshirë në trafikun e drogës, është një përgjegjësi e mazhorancës. Sipas Presidentit Nishani në këtë rast ka dështuar Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes e cila sipas tij është e politizuar. Ndërkohë Nishani deklaroi se mazhoranca i ka hequr Presidentit të Republikës kompetencat për të zgjedhur kreun e kësaj agjencie dhe sipas tij prandaj sot ndodhin këto raste. "Rasti i majorit të Forcave të Armatosura i cili ishte i përfshirë në rrjetin e drogës, duhet parë në këtë kontekst, se sa nuk kanë funksionuar institucionet që kanë për detyrë të hetojnë, monitorojnë dhe kontrollojnë përfshirjen e ushtarakëve në veprimtari të tilla kriminale. Agjencia përkatëse ka përgjegjësi të drejtëpërdrejtë dhe unë po pres të shoh angazhimin e institucioneve që ka në varësi kjo agjenci, që të vlerësojnë me shumë seriozitet këtë situatë", tha kreu i shtetit, Bujar Nishani.

Komisionet

Administrata

Balla, theksoi se më shumë sesa zgjatja në kohë e hetimeve është e nevojshme që në hetim të përfshihen edhe punësimet në bashkitë e drejtuara nga e djatha pas zgjedhjeve të 23 qershorit

Serveri

Në mbledhjen e djeshme është miratuar rregullorja e punës, ndërkohë që Klosi, gjatë mbledhjes deklaroi se historia është e vështirë të verifikohet pasi mazhoranca do të mbështes çdo hetim

të verifikohet, por se mazhoranca mbështet çdo hetim, marrje në pyetje apo verifikim faktesh, në bazë të ligjit për funksionimin e komisionit.

■ **PARK TURISTIK**

Gjithë zona e atyre ndërtimeve pa leje dhe asaj barbarie dhe kafshërie që u vu në jetë 20 vjet, me zhvillime të papërgjegjshme kthehet në një park të madh

■ **VLERËSIM INUK**

Kreu i qeverisë Rama ka shkruar në Facebook se ndjehet krenar për punën e INUK dhe i befasuar nga hapësira e mrekullueshme e vijës së rilindur të bregut liqenor

Rama: Fund barbarisë së ndërtimeve, tani vetëm park turistik

Kryeministri, i kënaqur nga puna e bërë në bregun e liqenit të Ohrit. Vlerësime maksimale për aksionet e INUK

POGRADEC

E shtë shprehur i kënaqur Kryeministri Edi Rama me punën që është bërë në bregun e liqenit të Ohrit. Shëtitorja 17.3 kilometra e liqenit të Ohrit, e gjelbëruar në të dyja anët e saj dhe një korsi për lëvizjen me biçikletë dhe një rrugë, që po ndërrohet sipas kryeministrit do të sjellë një pamje të re në hyrjen e qytetit të Pogradecit. "Objektivi është që kur të fillojë sezoni të jemi në kushte të tjera komplet, të jetë gjithçka e kalueshme dhe brenda vitit, ne ta kemi kryer totalisht si projekt, jo vetëm rrugën, por gjithë parkun, e rikthyer pas 30 vitesh siç nuk ka qenë para 30 vjetësh, me një rehabilitim që e bën praktikisht një nga zonat më të bukura turistike të rajonit dhe pa diskutim e kthen si zonë turistike me vlera të posaçme nga pikëpamja ekologjike, nga pikëpamja e peizazhit, e natyrës dhe patjetër, edhe nga pikëpamja e lëvizjes. Gjithë zona e atyre ndërtimeve pa leje dhe asaj barbarie dhe kafshërie që u vu në jetë 20 vjet, me zhvillime të papërgjegjshme, kthehet në një park të madh për qytetarët dhe në një aset të madh për gjithë turistët që mund të lëvizin, mund të shëtisin, mund të vrapojnë, mund të kenë vend fëmijët për të luajtur. 17 kilometra park, me korsi biçikletash", deklaroi Rama. Kryeministri theksoi se të gjitha këto ndërhyrje do ta kthejnë bregun e liqenit të Ohrit në një nga asetet e çmuara turistike të vendit. Përgjatë segmentit Lin-Pogradec po zbatohen projektet për rindërtimin e rrugës, rehabilitimin e gjelbërimitin e bregut të liqenit të Ohrit, të financuara nga qeveria. Drejtues të Autoritetit Krugor informuan se po punohet për përfundimin e rikonstruksionit të rrugës, për ta bërë atë të shrytëzueshme për sezonin turistik, ndërkohë ka nisur edhe projekti për shëtitoren. Ky projekt para-

shikon gjithashtu, pastrimin nga inertet dhe rehabilitimin e zonave të ndërtimeve të prishura, sisteminin e terrenit dhe gjelbërimitin e tyre.

■ **RAMA PËR INUK**

Kryeministri Edi Rama ka reaguar nga Pogradeci në lidhje me punën që INUK ka bërë në këtë qytet. Kreu i qeverisë Rama ka shkruar në faqen

■ **Turizmi**

"Me siguri këtë sezon turistik do jenë më të shumtë se asnjëherë vizitorët dhe këtë ndjesi të bukur do ta shijojnë që të gjithë", ka shkruar Rama, në rrjetin social".

e tij në Facebook se ndjehet krenar për punën e INUK dhe i befasuar nga hapësira e mrekullueshme e vijës së rilindur të bregut liqenor pas aksionit të disa ditëve më parë dhe punës që ka nisur për rehabilitimin e zonës. Tani, sipas kryeministrit, Pogradecit i është shtuar parku i ri natyror. Po ashtu Rama ka shprehur bindjen se për shkak të punës

që ka bërë INUK këtë vit numri i turistëve dhe i vizitorëve që do të frekuentojnë Pogradecin do të jetë më i shumtë se asnjëherë tjetër. "Me siguri këtë sezon turistik do jenë më të shumtë se asnjëherë vizitorët dhe këtë ndjesi të bukur do ta shijojnë që të gjithë", ka shkruar Rama, në rrjetin social për punën e këtij institucioni.



Punimet në bregun e liqenit të Ohrit



Rama gjatë vizitës në Pogradec

17.3

Kilometra është shëtitorja e liqenit të Ohrit, e gjelbëruar në të dyja anët e saj dhe një korsi për lëvizjen me biçikletë dhe një rrugë që po ndërrohet.

30

Vite i janë dashur këtij parku për tu rikthyer siç nuk ka qenë para 30 vjetësh, me një rehabilitim që e bën një nga zonat më të bukura turistike të rajonit.

TAKIMET

Denilson me Metën Nishanin e Bashën



— Në takimin që Presidenti Bujar Nishani pati me Drejtorin e Përgjithshëm për Zgjerimin në KE, Christian Danielsson u diskutua përfshirja e palëve politike për realizimin e reformave si dhe plotësimin e pesë prioritetëve që BE i ka vënë Shqipërisë për anëtarësim. Nishani tha se do mbështesë fort krijimin e Këshillit Kombëtar për Integrimin Evropian, me shpresën se ky do të jetë rezultat i bashkë dakordësive së palëve për adoptimin e modelit më të suksesshëm në interes të qytetarëve shqiptarë. Ndërsa kreu i Kuvendit Meta në takim me Danielsson, vlerësoi si mjaft pozitiv hapin që ndërmorën palët politike për gjithëpërfshirjen në arritjen e marrëveshjes së dhjetorit. Basha me Danielsson ndau shqetësimin për rritjen e kriminalitetit dhe depërtimin e krimin në nivelet e larta të qeverisjes.

Vonesa disa muaj

Nishani ka dekretuar Floreta Faber ambasadore në Uashington

— Presidenti Bujar Nishani ka dekretuar emërimin e Floreta Faber, si ambasadore në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. "Znj. Floreta Faber emërohet në detyrën e ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, rezident, dhe të ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Shtetet e Bashkuara të Meksikës, Republikën e Panamës dhe në Republikën Domenikane, jorezident", theksohet në dekretin e kreu të Shtetit. Floreta Faber zëvendë-

son në këtë post ambasadorin aktual Gilber Galanxhi, të cilin prej kohësh i ka mbaruar mandate, ndërkohë që dekreti për pasuesin e tij ka zgjatur në mënyrë të pashembullit. Kreu i shtetit Bujar Nishani, prej kohësh e ka mbaratur të bllokuar zëvendësimin e ambasadorit të Shqipërisë në Uashington dhe ky nuk është rasti i parë. Kohë më parë kryeministri Edi Rama ka zhvilluar një takim me kreun e shtetit vetëm për këtë çështje, por që nuk është bërë e mundur zgjidhja që në momentin e parë në mënyrë që partneri më i madh i Shqipërisë SHBA

të ishte i mbuluar me një titullar ambasade. Emri i Faber, Drejtore Elzekutive e Dhomës Amerikane të Tregtisë në Shqipëri, është propozuar nga qeveria dhe ministri i jashtëm, Ditmir Bushati muaj më parë. Ndërkohë që ka qenë gazeta "Shqiptarja.com", ajo që e ka bërë public emrin e Faber si kandidatë për postin e ambasadorit të vendit tonë në Uashington, ndonëse asokohe u kundërshtua si lajm dhe nga MPJ por dhe nga Presidencia. Dhe vetëm pas disa muajsh propozimi i saj u bë publik, ndërkohë që Nishani hezitoi.

VIDEO/ RAMA: FUND BARBARISË SË NDËRTIMEVE, TANI PARK TURISTIK

Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të A1REPORT që shkarkohet falas

» ZGJEDHJET

MOTOJA “de facto” dhe “de jure” vazhdon mbijetojë në radhët e Partisë Demokratike. Ku zyrtarisht Basha s’ka nisur ende përgatitjet e kandidatave për zgjedhjet, ndërsa Berisha ka nisur seleksionimin e tyre

Kandidatët, në PD vendos Berisha, mënjanohet Basha

Deputetët demokrat konsultohen me ish-kryetarin për kandidatët që do garojnë në zgjedhjet lokale

ERMIRA MRRUKU
TIRANE

Partia Demokratike vijon të mbetet ende një forcë politike me bashkëdrejtim që në momentin që lideri historik Berisha dha dorëheqjen dhe në krye të PD-së erdhi Lulzim Basha. Mesa duket për ish-kryeministrin Berisha është thujse e pamundur të shkëputet nga të qenit lideri de facto i Partisë Demokratike duke lënë kështu nën hije kreun aktual të selisë blu, Lulzim Basha. Meqenëse zgjedhjet lokale të 21 Qershorit po afrojnë ky është testi i parë për Bashën në krye të Partisë Demokratike, ku si humbja ashtu edhe fitorja do t’i faturohen atij. Megjithatë pavarësisht rrishtit që do të mbajë mbi supe për rezultatin e zgjedhjeve lokale, kreu demokrat Basha nuk do të jetë dhe aq i përfshirë në përzgjedhjen e kandidatave që do garojnë për krerët e 61 bashkive të vendit. Kjo për



rrjedhojë se Basha është lënë në hije dhe pothuajse është mënjanohet për të dhënë verdiktin se cilët do të jenë kandidatët e Partisë Demokratike në zgjedhjet e 21 Qershorit. Është lideri historik i së djathtës, Sali Berisha ai që ka kompetencat për të vendosur me një të rënë të lapsit se kush dhe cili do të jetë kandidati që do garojë për secilin nga 61 bashkitë e vendit. Sipas burimeve nga selia blu, gjithëkalon nga



Berisha

Ish-kryeministri Berisha edhe pse jo zyrtarisht, po merret intensivisht me përzgjedhjen e kandidatave të PD-së, të cilët do të garojnë për 61 bashkitë në zgjedhjet e 21 Qershorit.

tavolina e ish-kryeministrin Berisha, nëse emra të caktuar nuk marrin bekimin e tij, nuk ka asnjë shans për të qenë kandidat në zgjedhje. Sipas burimeve të “Shqiptarja.com” një praktikë të tillë po e ndjekin të gjithë deputetët e Partisë Demokratike të cilët sipas rasisht konsultohen më



Basha

Kreu aktual i Partisë Demokratike, Lulzim Basha është manjanohet thujse totalisht nga deputetët demokrat, të cilët sa i përket zgjedhjeve po konsultohen intensivisht me Berishën.

ish-kryeministrin Berisha. Deputetët demokrat kanë filluar punën me listat dhe emrat që ata mendojnë si potencial për të kandiduar në zonat e tyre. Ndërkohë që çdo emër i propozuar i serviret liderit historik të së djathtës, Sali Berisha, ndërsa ky i fundit bën gjykimin dhe



DEKLARATA

Spaho:
Kërkojmë
zgjedhje të
parakohshme



Nënkryetari i Parlamentit, Edmond Spaho, njëkohësisht nënkryetar i Partisë Demokratike thotë se zgjedhjet e parakohshme janë një opsion i dëshiruar për këtë forcë politike. I ftuar në studio në A1 Report, Spaho u pyet për deklaratat e ish-kryeministrin Sali Berisha të bëra dje në Kuvend, ku theksoi se vendi duhet të shkojë në zgjedhje të parakohshme parlamentare. “Sigurisht kjo është një nga objektivat tona. Çdo parti e madhe opozitare kërkon zgjedhje të parakohshme. Në do punojmë t’ia shkurojmë ditët qeverisë, qoftë dhe me protesta”, tha Spaho.

Strategjia e opozitës për zgjedhjet lokale të 21 Qershorit

PD po trajnon të rinj nga i gjithë vendi për fushatën elektorale



Partia Demokratike ka zgjedhur të vijë me risi në fushatën elektorale për zgjedhjet lokale të 21 Qershorit. Ndryshe nga herët e tjera Partia Demokratike ka zgjedhur që në fushatë elektorale të këtë të përfshirë në stafin e saj sa më shumë të rinj dhe të reja. Strategjia e demokratëve është që në fushatën elektorale për 61 bashkitë e vendit platformat e kandidatëve që do të garojnë të përvetësohen më së miri edhe nga të rinjtë e zonave përkatëse të cilët do të jenë të përfshirë intensivisht në fushatë



elektorale. Kështu prej mëse një muaji në selinë e Partisë Demokratike po trajnohen një grup të rinj nga të gjithë zonat e vendit për mënyrën e të bërit fushatë elektorale dhe mënyrën e pasqyimit të platformave elektorale. Trajnimi i të rinjve nga Partia Demokratike po bëhet në bashkëpunim me fondacionin gjerman “Conrad Hasenauer”. Këtë e konfirmojnë burime nga Partia Demokratike, të cilët thonë se grupi i të rinjve që po trajnohet pranë selisë PD-së në

Tiranë do të shpërdahen më pas në rrethet e tyre përkatëse ku do të zhvillojnë takime intensive me të rinjtë nëpër zona. Takimet e grupit që po trajnohet pranë selisë blu me të rinjtë e zonave, do të jenë sërish në kuadër të trajnimeve për mënyrën se si do të organizohet dhe zhvillohet fushata elektorale e Partisë Demokratike. E gjithë kjo bëhet me synim mobilizimin dhe përfshirjen e sa më shumë të rinjve në fushatën elektorale të zgjedhjeve lokale të 21 Qershorit.



Përgatitjet

Fushata e PS-së në zgjedhjet vendore të vitit 2015 po vijon sipas ndarjes së re territoriale, ku njësia më e vogël administrative është lagja

Lagja

Në ligjin e ndarjes së re, thuhet shprehimisht se "Qytetet mund të ndahen në njësi më të vogla që quhen lagje dhe një lagje mund të krijohet vetëm në terriore me mbi 20 mijë banorë".



PBDNJ

Nënkryetari i Kuvendit dhe kreu i PBBDNJ-së Vangjel Dule ka deklaruar se do të dalë me kandidatë të ndryshëm nga ata të koalicionit të majtë, duke shprehur rezerva për PS



PS edhe fushatën e organizon sipas ndarjes së re territoriale

Në çdo njësi vendore prej dy javësh udhëzim për organizimin në lagje

JUXHIN MUSTAFARAJ
TIRANE

Partia Socialiste ka nisur prej dy javësh organizimin për zgjedhjet vendore të 21 qershorit. Sipas burimeve brenda PS, bëhet e ditur se me udhëzim të kryetarit të PS-së dhe kryeministrit Edi Rama, fushata ka nisur duke ju përmbajtur plotësisht ndarjes së re territoriale të miratuar nga




mazhoranca. Kështu prej dy javësh, PS ka dërguar një shkresë zyrtare për strukturat socialiste në rrethe në të cilën udhëzon që përgatitjet në zgjedhjet lokale të nisin nga njësia më e vogël administrative sipas hartës së re. Kështu sipas burimeve në selinë rozë, mësohet se që pas shpërndarjes së udhëzimit në të gjitha qarqet e vendit ka nisur organizimi në njësitë më të vogla, të cilat sipas ndarjes së re janë lagjet. Në ligjin e ndarjes së

re territoriale, thuhet shprehimisht se "Qytetet mund të ndahen në njësi më të vogla që quhen lagje dhe një lagje

mund të krijohet vetëm në terriore me mbi 20 mijë banorë". Pikërisht sipas kësaj logjike, strukturat e PS-së në rrethe kanë bërë ndarjen e përgjegjësi me drejtuesit e PS për organizimin e fushatës për zgjedhjet vendore të vitit 2015. Nisja e fushatës në këtë lloj forme është menduar si një strategji e mirëfilltë e të majtëve të cilët kanë kërkuar që fushata deri në propozimin e emrave të nisë nga strukturat më të thjeshta për të mbërritur deri në kryesinë e PS-së, e cila do të vendosë edhe për emrat. Burime pranë anëtarëve të grupit të punës që realizojnë edhe takimet me strukturat socialiste viti-tin e kaluar, pohojnë se në shkurt do të rifilloj puna me krerët e PS-së në rrethe. Deputetët Blendi Klosi, Blerina Gjylameti dhe Musa Ulqini, ndryshe nga faza e parë që ka qenë thjesht konsultative me drejtuesit e PS-së në rrethe, që nga shkurti do të sjellin propozimet konkrete që drejtuesit në rrethe sygjerojnë. Ndonëse në pjesë e madhe e kandidatëve aktualë të zgjedhur nga e majta kanë shprehur dëshirën për të rikandiduar sërisht, ndarja e re territoriale dhe ulja e numrit të njësi vendore ul ndjeshëm mundësitë për ta.

Vakancat



Denar Biba

Denar Biba është rizgjedhur me katër vota në postin e nënkryetarit, dy vjet pasi dha dorëheqjen nga i njëjti post në prill të vitit 2013.



Leferije Luzi

Bëj thirrje që të bashkëpunojmë që të realizojmë zgjedhje të lira dhe të ndershme të cilat të mos kontestohen dhe të pranohen nga të gjithë



Godina e KQZ

KQZ do të zhvendoset në një godinë të re në ish-ambjentet e Ministrisë së Mbrojtjes e cila pritet të jetë gati përpara zgjedhjeve në qershor 2015

Intitucionet

TIRANE

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve është gati të fillojë punën për zgjedhjet e 21 qershorit, pas plotësimit të tre vakancave. Dy anëtarët e përzgjedhur nga PS, Denar Biba dhe Edlira Jorgaçi dhe anëtarët i LSI-së Gëzim Veleshnja, kanë zhvilluar dje mbledhjet tyre të parë në KQZ. Një ditë pasi morën miratimin e Kuvendit, tre anëtarët e rinj kanë zhvilluar dje mbledhjen e tyre të parë në KQZ, e cila në rend të ditës kishte përzgjedhjen e nënkryetarit të saj. Me votimin e shtatë anëtarëve, Denar Biba është përzgjedhur nënkryetari i KQZ-së me katër vota, përballë tre votave të tjera që shkuan në favor të anëtarës

KQZ gati të përgatis zgjedhjet, Biba zgjidhet nënkryetar

Plotësëohen vakancat. Luzi: Bashkëpunojmë për zgjedhje të lira

tjetër të PS-së, Edlira Jorgaçi. Denar Biba është rizgjedhur në postin e nënkryetarit, dy vjet pasi dha dorëheqjen nga i njëjti post në prill të vitit 2013. Rikthimi i përfaqësuesve të mazhorancës në KQZ, është përshëndetur edhe nga përfaqësuesit e opozitës, të cilët shprehën dëshirën dhe vullnetin për të bashkëpunuar në

zgjedhjet e ardhshme vendore të 21 qershorit. Kryetarja e këtij komisioni, Leferije Luzi duke ju referuar tashmë edhe konfigurimit të plotë të KQZ-së bëri apel që të punohet për zgjedhje të lira e të ndershme. "Duke përshëndetur rikthimin e përfaqësuesve të rinj të mazhorancës, bëj thirrje që të bashkëpunojmë që të realizojmë zgjedhje të lira dhe të ndershme të cilat të mos kontestohen dhe të pranohen nga të gjithë", deklaroi Luzi. Ky proces sipas kryetares së KQZ-së do të jetë një lloj sfide për shkak të ndryshimeve të bëra në Kod, të cilat duan kohë të kuptohen, reflektohen dhe më pas të kthehen në akte. Sa i takon 183 Bashkive dhe Komunave që nuk kanë dorëzuar ende materialet zgjedhore, kryetarja e këtij institucioni ka ripërsëritur apelin për këto njësi vendore në mënyrë që procesi të vijoj normalisht. Pas fondit të miratuar dhe akorduar nga qeveria, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve do të zhvendoset në një godinë të re



në ish-ambjentet e Ministrisë së Mbrojtjes. Tashmë janë duke u përgatitur procedurat e prokurimit për të bërë rikonstruksionin e ambienteve, ndërkohë që institucioni pritet të jetë gati në qershor 2015 nga ku do të bëhet edhe raportimi në kohë reale i rezultateve të zgjedhjeve vendore të 21 qershorit.

SHPALLJE ANKANDI

SHOQËRIA PËRMBARIMORE "ARDAEL" shpk, shpall shitjen në ankand të dytë për pasurinë: " Arë", me sipërfaqe 500 m2, me adresë në fshatin Dobresh, Tiranë në pronësi të Fatime Hidri, për detyrimin e debitorit Zija Hidri me çmim fillestar **1,562,400 (një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e katërqind) lekë**. Ankandi zhvillohet në datë **19.02.2015 ora 15:30**.


Personat e interesuar mund të kontaktojnë në numrin: **0672027883**; e-mail: **ardael2004@yahoo.com**; web: **www.ardael.com** ose në adresën rr. "Khorxh W Bush", Kulla 1, Kati I, poshtë lokal Elizes, përballë Parlamentit, Tiranë.

Premtimet

Të rinjtë gjatë protestës së tyre kanë përmendur të gjitha premtimet e bëra nga Bashkia e Tiranës para 4 vjetëve, të cilat ende nuk janë realizuar tashmë në fund të mandatit të saj.

Paditë penale

Brenda kësaj jave Bashkia e Tiranës ka depozituar 4 padi të ndryshme në Prokurorinë e kryeqytetit për shkak të përplasjeve që ka pasur me institucionet qeveritare si Polici, MMRS dhe INUK



Protesta e të rinve para Bashkisë së Tiranës

LAJME shkurt

Pr/ligji i Arsimit të Lartë, UT kundër draftit

Pr/ligji i ri i Arsimit të lartë cenon autonominë dhe financat e universitetit. Kjo ka qenë deklarata e bërë nga Senati i Universitetit të Tiranës pas një mbledhjeje ku ka diskutuar ndryshimet më të fundit që paritet të bëhen këtij ligji. "Ky draft e përkeqëson situatën. Në të gjithë frymën e vet ky draft e përkeqëson institucionin akademik. Këtë edhe një institucion, një SHPK, nuk do të funksiononte. E cënon totalisht autonominë, janë mbi 90 nene ku vendimmarrjet dalin jashtë universitetit", tha Dhori Kule, rektor i universitetit të Tiranës. Sipas tij, drafti ka një sërë mangësisht duke filluar nga nga mënyra e përzgjedhjes së organeve drejtuese deri tek skema e financimit që do të përdoret. Rekomandimet për draftin e ri të arsimit të lartë do ti përcillen ministrisë së Arsimit dhe Sportit, si dhe komisionit të ngritur për hartimin e tij. Ndërkohë zv/ministri i Arsimit Arbian Mazniku ka pohuar se MAS do të jetë e hapur për prirjen e rekomandimeve dhe diskutimeve të tyre në mënyrë që ky ligj të jetë sa më funksional.

Protestë para Bashkisë, të rinjtë: S'mbajti premtimet Ndërtimi i 11 katëshit, Bashkia padi për kreun e INUK

SONILA ISAKU TIRANË

Mungesa e qendrave rinore, ambienteve ku mund të kalohet koha e lirë, a por edhe premtimet e pambajtura të Bashkisë së Tiranës kanë detyruar një grup të rinjsh të protestojnë përpara këtij institucioni. Shkak për këtë protestë duket se është bërë edhe përplasja mes Bashkisë së Tiranës dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale, sa i përket punimeve që po kryhen për qendrën rinore në Krugën e Kavajës.

PROTESTA

Të rinjtë protestues kanë pohuar se prej 4 vjetësh bashkia nuk ka mbajtur premtimet e bëra siç është edhe karta e studentit, a hapësirat publike, ndërtimi i shkollave apo edhe tramvajit. "Prej kohësh flitet se të rinjtë shqiptarë e

humbin kohën e tyre nëpër kafene e kazino. Por, mjafton të hedhësh sytë rreth e rrotull për të kuptuar se në kryeqytet nuk ka as edhe një copë vend ku ne të rinjtë të kalojmë kohën, të ndihemi të përfaqësuar apo për ta shfrytëzuar si një ambient kreativ. Ndaj jemi mbledhur para Bashkisë së Tiranës për të thënë se na mungojnë qendrat rinore, hapësirat publike dhe një vëmendje më e madhe nga Bashkia e Tiranës" kanë pohuar të rinjtë gjatë protestës së tyre. Po ashtu, ata nuk kanë harruar të përmendin as ndërtimin e tramvajit apo edhe të institucioneve arsimore të cilët ishin premtime të pambajtura. "Ajo çka po kërkojmë sot është të mos na gënjëjnë më sepse askush nuk e beson. Kësisoj, i bëjmë thirrje kryebashkiakut të Tiranës që të paktën, minimalisht, të na kërkojë ndjesë për mashttrimin që na bëri 4 vjet më parë dhe të mbajë përgjegjësi për lënien pas dore të të rinjve kryeqytetas" kanë pohuar të rinjtë protestues.



Dallëndyshe Bici

PADIA

Por, bashkia e Tiranës nuk ka patur një përgjigje për të rinjtë protestues sa i përket premtimeve të pambajtura, për vetë faktin se gjatë ditës së djeshme ky institucion është marrë me kallëzimin penal ndaj kreut të INUK-ut,

Dallëndyshe Bici, për kallëzim të rremë në lidhje me pallatin që po ndërtohet pranë shkollës së mesme të Gjuhëve të Huaja në Tiranë. Në një deklaratë për media Bashkia e Tiranës sqaron se "leja e miratuar është në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe legjislacionin në fuqi për planifikimin e territorit. Është respektuar lartësia e propozuar nga Plani i Përgjithshëm Vendor për strukturat e kategorisë banim, si dhe distancat me strukturave nga kufiri i pronës që zhvillohet apo nga trupi i rrugës", sqaron Bashkia. Kallëzimi për kreun e INUK-ut, sqarohet në deklaratë, u shtohet kallëzimeve të tjera të zyrtarëve të lartë, siç është ai për ministrin Erion Veliaj apo ministrin e Financave Shkëlqim Cani për shpërdorim detyre. Sipas Bashkisë, ministri i Financave ka bllokuar prej një viti pagesat ndaj dy kompanive të cilat po punojnë për dy projekte të mëdha siç janë Bulevardi i Tiranës dhe rehabilitimi i lumit Tirana.



Tregtarët e shumicës në protestë për qeranë e lartë

Rreth 500 tregtarë të tregut të fruta-perimeve në Kasha janë ngritur në protestë kundër qirasë së ambienteve, që sipas tyre është rritur. Tregtarët thonë se këto tubime do të vijojnë, deri në bllokim të autostradës Tirane-Durrës. "E kemi qiranë nga 12 mijë lekë të vjetra deri 25 mijë lekë për metër katror. Kjo është pika kryesore, ka shumë biznese që kanë falimentuar. Të pastrohet ky mall për 4-5 ditë, ne pastaj do të hidhemi në protestë më të madhe që do të bllokojmë rrugën". Nga ana tjetër, tregtarët i bëjnë thirrje institucioneve përkatëse që të mos lejojnë informalitetin brenda tregut. Por drejtues të administratës së tregut kanë sqaruar për se nuk ka asnjë rritje të qerësë mujore të ambienteve ku tregtarët shesin, por atyre iu është kërkuar një pagesë prej 4 mijë lekësh për pajisjen me NIPT të të gjitha bizneseve që tregtojnë brenda këtij tregu.

Arsimi profesional, Veliaj: Tregu ka nevojë për teknicienë Nxënësit 30% të procesit mësimor praktikë pranë bizneseve

Punësimi TIRANË

Tregut të punës sot i mungojnë ekspertë në miniera, bujqësi, sektorin e elektricitetit etj, ndaj frekuencimit i shkollave profesionale do të ishte zgjedhja e duhur për të siguruar edhe një vend pune. Kjo ka qenë deklarata e bërë nga Ministria e Arsimit, Lindita Nikolla dhe ai i Mirëqenies Sociale, Erion Veliaj gjatë një takimi me drejtues të shkollave profesionale. Sipas tyre, nxënësit e këtyre shkollave do të kalojnë të paktën 30% të kohës së procesit mësimor pranë bizneseve, sipas degëve përkatëse, për t'u praktikuar. "Ky është një model i ri, pra për herë të parë bordi i shkollës do



Nikolla Ka shprehur angazhimin e saj maksimal për arsimin profesional, që sipas saj ndikon në uljen e papunësisë në vend. "MAS dhe qeveria shqiptare do t'u japin projekteve të tilla

të ketë një përfaqësues biznesi, i cili do të ketë edhe disa kompetenca. Ne kemi shpërndarë një udhëzim, ku rrisim kompetencat e përfaqësuesve të biznesit në mënyrën sesi menaxhohet shkolla, në mënyrën e ofertës që shkolla jep për arsimin profesional, në mënyrën sesi ne zgjedhim mësuesit sipas profileve, e sigurisht edhe në mënyrën sesi ne realizojmë praktikatat mësimore. Duke filluar nga ky vit, ne kemi kërkuar që 30% e kohës mësimore të një nxënësi do të duhet të kalohet pranë një biznesi përveç asaj në klasë", u shpreh ministri

Erion Veliaj. Ndërsa ministria Nikolla ka shprehur angazhimin e saj maksimal për arsimin profesional, që sipas saj ndikon në uljen e papunësisë në vend. "MAS dhe qeveria shqiptare do t'u japin projekteve të tilla, duke shërbyer fort si një urë e madhe lidhëse për rritjen e punësimit, por edhe për të qasur shprehitë dhe cilësinë e formimeve me atë që kërkon sot zhvillimi i vendit, specifikkisht në fushën e bujqësisë", tha ministria Lindita Nikolla. Deklaratat janë bërë gjatë një aktiviteti me drejtues të shkollave profesionale.

Platforma e vizioni

Kandidati për postin e Guvernerit të Bankës së Shqipërisë Gent Sejko, paraqiti vizionin dhe platformën e tij për drejtimin e institucionit qendror bankar




Vjedhja e thesarit

Sejko e vuri theksin te nevoja që ka ky institucion për të rritur masat mbikëqyrëse të kontrollit si dhe zbardhjen e plotë të vjedhjes së 713 milionë lekësh

Përgjegjësit

Një nga prioritetet është vlerësimi i dokumenteve, pasqyrave financiare, për të vlerësuar nëse është e saktë vlera e vjedhur nga thesari, por dhe përgjegjësit



Kredia e keqe

Shkaku kryesor për kredinë e keqe, sipas Sejkos ka qenë rendja nga ana e bankave në industri të cilat kanë pasur rritje të theksuar dhe ardhja e krizës

LORENC RABETA
TIRANE

Kandidati për postin e Guvernerit të Bankës së Shqipërisë Gent Sejko, ka marrë dje votat pro të Komisionit Parlamentar të Ekonomisë, ku ka paraqitur edhe vizionin e tij për drejtimin e institucionit qendror bankar. Ndërsa renditi para komisionet Komisionit platformën dhe prioritetet e tij në drejtimin e Bankës së Shqipërisë, Sejko e vuri theksin te nevoja që ka ky institucion për të rritur masat mbikëqyrëse të kontrollit si dhe zbardhjen e plotë të vjedhjes së 713 milionë lekësh. "Një nga prioritetet është vlerësimi i dokumenteve, pasqyrave financiare, për të vlerësuar nëse është e saktë vlera e vjedhur nga thesari, po ashtu për të parë edhe nëse daljet e përgjegjëse janë të sakta", tha Sejko para Komisionit.

SISTEMI I KONTROLLIT

Sipas Sejkos thelbësor është rishikimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm të Bankës së Shqipërisë të cilat kanë dështuar, referuar ngjarjes së ndodhur dhe disa departamente dhe funksione të Bankës qendrore që nuk kanë qenë në lartësinë e duhur, si departamenti i thesarit, i kontrollit të brendshëm, i administrimit. "Pra, duhen riparë sepse është e dukshme që këto departamente nuk kanë kryer rolin dhe funksionin e tyre", tha Sejko, kandidaturë e propozuar nga Presidenti i Republikës Bujar Nishani. Deputetët kërkuar të dinin se çfarë do të bënte Gent Sejko në drejtimin e BSH-së, lidhur me komisionet e larta me të cilat operon sistemi bankar shqiptar, interesat e kredive dhe nive-

Komisioni "OK", Sejkos: Do zbardh vjedhjen në BSH

Komisioni i Ekonomisë dëgjon platformën për drejtimin e Bankës së Shqipërisë, të enjten në Kuvend



Gent Sejko

lin e lartë të kredive me probleme. "Shkaku kryesor për kredinë e keqe ka qenë rendja nga ana e bankave në industri të cilat kanë pasur rritje të theksuar dhe ardhja e krizës, dhe vendosja e këtyre industrive

në pozicione të vështira, por dhe mungesa e profesionalizmit, për të thënë realitetin, nga ana e bankave për të bërë një strukturim të duhur të portofolave të kredisë dhe të kredive ndaj klientëve. Sfida e Bankës

Qendrore dhe Bankave të nivelit të dytë është hedhja e këtij likuiditeti në ekonomi. Pra, sfida është si të bëjmë, të përkthejmë këto para në kredi në mënyrë që bankat të mos i vendosin në placement, në vendosje në bankat


e huaja, po ti hedhin në kredi në ekonominë shqiptare", tha Sejko.

PAGA

I pyetur nga anëtari demokrat në këtë komision, Florion Mima, nëse do të rishikojë pagën e Guvernerit dhe të punonjësve të Bankës Qendrore, Sejko tha se do të kontraktohet një kompani e posaçme për të bërë vlerësim objektiv duke e krahasuar me vendet e tjera të Rajonit. Ai tha se nëse ka diferencë të thellë dhe mbivlerësim në pagë, është i hapur për të bërë studim në rajon për të parë raportet e bankave qendrore në raport me industrinë brenda të cilave ata operojnë. Po nga ana tjetër të jemi në treg që mos të nënvlerësojmë dhe të kemi humbje të burimeve njerëzore. Me ato raporte që kam parë BSH është konkurruese, ndoshta dhe diçka më poshtë se bankat e nivelit të dytë që kanë paketa më atraktive. Çdo rishikim i pavlerësuar i paketave të këtyre punonjësve, do të kishte rrjedhje të stafit dhe pozicione të tjera jashtë bankës. Nëse do të ketë shpërpjesëtim në raport me Rajonin do të jem i hapur të bëj rishikime, nëse ka fryrje, do ta rishikoj", tha Sejko. Kreu i komisionit Erjon Braçe vlerësoi si të ligjshme procedurat e ndjekura për kandidaturën e Sejkos, duke i hapur rrugë votimit në Kuvend të enjten e ardhshme. "Nominimi nga ana e presidentit të Republikës të zotit Sejko është në përputhje me ligjin dhe i kalon seancës plenare në vlerësimin e tij lidhur me dekretin e Presidentit të Republikës për të votuar ditën e enjte të javës tjetër", tha Braçe.



2015
Banka Botërore njoftoi se gjatë 2015-ës do të akordojë 163 milionë dollarë financime për qeverinë shqiptare. Shuma përfshin hua nga bankat IBRD dhe IDA



Kushti
Ky fond mund të tërhiqet vetëm nëse pala shqiptare arrin të sjellë në nivelet e kërkuara projektet e rena dakord më parë me Bankën Botërore

Investime për vitin 2015 në infrastrukturë BB, 163 milionë dollarë financime për qeverinë shqiptare

Banka Botërore njoftoi se gjatë 2015-ës do të akordojë 163 milionë dollarë financime për qeverinë shqiptare. Shuma përfshin hua nga bankat IBRD dhe IDA, degë të BB dhe janë të orientuara kryesisht për sektorët e infrastrukturës në vendin tonë. Ky fond mund të tërhiqet vetëm nëse pala shqiptare arrin të sjellë në nivelet e kërkuara projektet e rena dakord më parë me BB. Vlera më e lartë e fondeve të vëna në dispozicion nga Banka Botërore i takon vitit 2014, për shkak të problematikës të madhe që krijoi në ekonominë e vendit sektori i energjisë elektrike. Banka Botërore autorizoi vjet financime 316 milionë dollarë. Kjo shumë erdhi edhe

si mbështetje direkte për disa reforma të mëdha që qeveria mori në pensione, shërbimin social dhe një strategji për menaxhimin e financave publike deri në vitin 2020. Para vitit 2014 financimet kanë qenë në vlera shumë herë më të ulta. Kështu, në vitin 2013, angazhimet e BB ishin vetëm 45 milionë dollarë. Financimet vijnë në një vit kur Banka Botërore parasheh zhvillime pozitive për ekonominë shqiptare. Vetëm pak javë më parë Banka Botërore publikoi pritshmëritë për zhvillimin ekonomik në Shqipëri duke parashikuar se ritmet do të përshejtohen në 3 për qind për vitin 2015 dhe në 4 për qind vitin e ardhshëm.




2014
Vlera më e lartë e fondeve të vëna në dispozicion nga Banka Botërore i takon vitit 2014, për shkak të problematikës të madhe që krijoi sektori i energjisë



Pritshmëritë
Banka Botërore publikoi pritshmëritë për zhvillimin ekonomik në Shqipëri duke parashikuar se ritmet do të përshejtohen në 3% për 2015 dhe në 4% për 2016

Hoxha kërkon lirinë

Apeli në 6 shkurt gjykon dosjen "Kokaina"



Ermal Hoxha

— Gjykata e Apelit për Krime të Rënda më 6 shkurt do të nisë për herë të parë shqyrtimin e kërkesave për ndryshimin e masës së sigurisë për të arrestuarit e dosjes "Kokaina". "A1 Report" ka mundur të mësojë se dy prej të arrestuarve Kelmend dhe Arjan Dalipi kanë kërkuar lirinë duke argumentuar se ata magazinën ku u gjet laboratorit i drogës e kishin dhënë me qira tek të tretët për biznes bojrash e s'kanë asnjë lidhje me drogën. Po ashtu mësohet se në apel do të shqyrtohet dhe kërkesa e nipit të ish-diktatorit Hoxha, Ermal Hoxha i cili kërkon heqjen e arrestit me burg pasi në pretendimet e tij Ermali ka mohuar lidhjen me drogën duke pranuar se ka shërbyer vetëm si taksist për kolumbianët pa e ditur se me se mereshin ata. I konsideruar si kreu i trafikut të drogës, i hetuar fillimisht nga autoritetet gjermane, Ili Hyseni nuk ka apeluar masën e arrestit me burg, thanë burime pranë gjykatës. Laboratori i drogës u zbulua në 15 janar nga një operacion i përbashkët me autoritet Gjermane. Ka qënë pikërisht prokuroria e Hanoverit ajo që ka zbuluar këtë informacion se mes Shqipërisë dhe Gjermanisë ishte mjaft aktive një linjë kokaine, e cila organizohej nga Ili Hyseni dhe persona të tjerë me vendodhje në Shqipëri. Gjatë operacionit janë arrestuar dhe proceduar plot 9 persona, ku 8 prej tyre u kapën në laboratorin e kokainës.

I refuzohet eksperti revoltohet Mziu ikën nga salla e gjykimit

— Rrëzohet kërkesa për caktimin e ekspertit fiskal Xhelal Mziut i caktohet një avokate kryesisht

ELTON QYNO
TIRANE

Xhelal Mziu, kryebashkiaku i Kamzës ka braktisur procesin gjyqësor në shenjë demonstrative, pas rrëzimit të kërkesës për caktimin e një eksperti fiskal. Mziu e ka komentuar vendimin e gjykatës si të njëanshëm dhe për pasojë, është larguar së bashku me avokatin e tij Genc Gjo-kutaj dhe bashkë të pandehurinjve tjetër në këtë proces, Atli Hoti. Largimi është bërë pikërisht në momentin kur gjykata i ka dhënë fjalën prokurorës Sevdari, për të lexuar konkluzionet përfundimtare për Mziun dhe dy zyrtarët e tjerë të bashkisë Kamëz. Shkak për këtë largim u bë vendimi i gjykatësist Besnik Hoxha për rrëzimin e kërkesave të Mziut dhe mbrojtësit e tij, se gjykata duhet të caktonte një ekspert fiskal për të parë nëse taksa, objekt gjykimi, ishte apo jo e zbatuar në paketën fiskale të miratuar në Bashkinë Kamëz. Gjithashtu në seancën e djeshme, gjykatësi Besnik Hoxha, rrëzoi dhe kërkesat e drejtorit ekonomik të Bashkisë Kamëz Bujar Loshi, për të thirrur si

Përgjigjia
"Nuk don z.Xhelal Mziu".
Kjo është përgjigjia që për disa muaj me rradhë përfaqësuesit e kompanisë "Gjoka Konstruksion" kanë marrë nga zyrtarët e bashkisë së Kamzës dhe më konkretisht nga avokati i këtij institucioni Atlis Hoti.



Xhelal Mziu

avokatëve mbrojtës. Nisur në këto rrethana, gjyqtari Besnik Hoxha, ka shqyrtë seancën gjyqësore për në datën 6 shkurt, ku pritet të lexohen konkluzionet përfundimtare të organit të prokurorisë, e cila do kërkojë deklarim fajtor të tre zyrtarëve të bashkisë Kamëz, për akuzën e "Shpërdorimit të detyrës" dhe "Moszbatim të vendimeve gjyqësore". Pikërisht në seancën e 6 shkurtit, gjykata ka zgjedhur të caktojë avokatë kryesisht të pandehurit Xhelal Mziu, ku mësohet se është avokatia Nevila Pushi, ndërsa për të pandehurinj tjetër Atlis Hoti është caktuar avokate kryesisht Mirela Rate.

VIDEO / MZIU BRAKTIS SEANCEN GJYQËSORE

Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të A1REPORT që shkakohet falas

dëshmitarë në këtë proces ish-drejtesit e Bashkisë Kamëz dhe Prefektët Besnik Bare, Keltis Kruja e Sadi Vorpsi. Fill pas këtyre vendimi, Mziu është çuar i nervozuar nga banka e të pandehurit dhe është larguar nga salla e gjykimit në shenjë demonstrative, duke i cilësuar vendimet e gjykatës si të njëanshëm.

AVOKAT KRYESISHT
Fill pas largimit të Xhelal Mziut, procesi gjyqësor nuk ka vijuar më tepër, kjo për shkak jo vetëm të mungesës së të pandehurve por edhe të

DY KALLËZIMET
Një vitë më parë njësi hetimore Task-Forcë pranë prokurorisë së Tiranës, i ka dhënë fund hetimit për Xhelal Mziun, juristin e bashkisë Atlis Hotin dhe drejtorin e tatimeve në këtë bashki Bujar Loshi. Vendimi për marrjen të pandehurit të Drejtorit të Takasave, ka ardhur pas verifikimit të kallëzimit penal që kanë bërë ndaj dy kompanitë "Gjoka Konstruksion" dhe "Albavia Sh.p.k.", të cilat janë ngarkuar me taksa në mënyrë të padrejtë nga ana e bashkisë së Kamzës.

LAJME shkurt

Shiu, bllokun rrugën Tiranë-Elbasan

— Reshjet e shiut të këtyre ditëve kanë sjellë bllokimin e segmentit rrugor Tiranë-Elbasan. Lajmi bëhet i ditur nga vetë Autoriteti Rrugor Shqiptar, sipas të cilit aksi Tiranë-Elbasan do të jetë i bllokuar për gjithë fundjavën, deri në një njoftim të dytë. Kjo pasi sipas ARRSH reshjet e shiut, mund të krijojnë probleme sa i përket rrëshqitjes së dherave, veçanërisht në zonën e Ibsës. Nga ana e tij Autoriteti Rrugor rekomandon drejtuesit e automjeteve që përgjatë këtyre ditëve të përdorin për qarkullim aksin Tiranë-Rrogzohinë.



Kukës, bllokohet 600 kg kafe kontrabandë

— Efektivët e policisë së Kukës kanë sekuestruar një sasi prej 600 kilogram kafe, origjina e së cilës ende nuk dihet. Burime zyrtare të policisë së Kukës, bëjnë të ditur se si rezultat i informacioneve të marra dhe veprimeve hetimore të kryera nga strukturat e Policisë Qarkut Kukës është bërë e mundur kapja në flagrancë e shtetasit Sokol Zyberi, 44 vjeç, lindur në Topojan e banues në Tiranë. Me automjetin e tij tip "Benz Sprinter" me targa AA428T po transportonte një sasi të konsiderueshme kafeje kontrabandë. Sapo një fakt i tillë është evidentuar, ekspertët e policisë kanë sekuestruar automjetin.

Gruaja e ministrit kosovar helmohet në Patok

— Bashkëshortja e ministrit të Brendshëm të Kosovës Skënder Hyseni mësohet se është ndjerë keq pas një drekë në Patok. Menjëherë u dërgua në spitalin e Laçit për të marrë ndihmën e parë. Mjekët thanë se kemi të bëjmë me një helmim. Por pas mjekimit e shoqja e ministrit të Brendshëm Hyseni la ambientet e spitalit për të vazhduar aktivitetin e planifikuar. Kujtojmë se ministri Hyseni ndodhej në Shqipëri pas një takimi që zhvillimi me ministrin e Brendshëm Sajmir Tahiri ku u diskutua për bashkëpunimin mes dy policive.

Vendimi
TIRANE

Atentati ndaj Serjanit, mbaron afati 20 ditor për 2 kushërinjtë

Aurel dhe Amarildo Hoxha sot dalin para gjykatës

Dy kushërinjtë Aurel dhe Amarildo Hoxhallari pritet të dalin sot paradite para Gjykatës së Krimeve të Rënda, për të mësur nëse do të lirohen apo do vijojnë të qëndrojnë në qeli. Të arrestuarit janë proceduar penalisht si organizator të atentatit të 5 janarit, ku mbeti i plagosur shtetasi Pajtim Serjani, polici i GOS Roland Meta dhe i vrasë shtetasi i cilësuar nga policia si vrasës me pagesë Arjanit Sterjo. Kushërinjtë akuzohen për „Vrasje me paramendim“ të mbetur në tentativë e kryer kjo në formën e „Grupit të strukturuar kriminal“. Aurel dhe Amarildo Hoxhallari



Arjanit Sterjo ose Artur Baze

Afati
Prokuroria e Krimeve të Rënda, kërko caktimin e masës së sigurisë arrest 30 ditor, ndërkohë gjykata vendosi të lerë 20 ditë në qeli dy kushërinjtë.

u kapën tre ditë nga atentati mafioz, ndërkohë që në ansjë moment nuk e kanë pranuar akuzën e ngritur nga policia. Si pasojë e provave jo bindëse, Prokuroria e Krimeve të Rënda, kërko

caktimin e masës së sigurisë arrest 30 ditor, ndërkohë gjykata vendosi të lerë 20 ditë në qeli dy kushërinjtë. Ky afat ditën e sotme përfundon dhe se pritet një vendim dytë nëse do lirojnë ose jo dy kushërinjtë Hoxhallari. "Pas disa hetimeve paraprake të bëra në funksion të hetimit lidhur me ngjarjen e ndodhur me dt 05.01.2015 në Rr.Kavajës ku është tentuar të vritet me armë zjarri shtetasi Pajtim Serjani si dhe është vrarë me armë zjarri shtetasi Arjanit Sterjo , u bë ndalimi i shtetasve Aurel Hoxhallari

37 vjeç, lindur dhe banues në Tiranë me gjendje gjyqësore i proceduar me parë për disa vepra penale, dhe Amarildo Hoxhallari, i moshës 24 vjeç lindur dhe banues në Tiranë" tha policia. Në njoftimin e policisë thuhet se vazhdojnë hetimet lidhur me dokumentimin e plotë ligjor të kësaj ngjarje kriminale, ndërsa materialet procedurale në ngarkim të shtetasve të lartpërmendur do t'i kalojnë Prokurorisë për veprën penale të "vrasjes me paramendim" mbetur në tentativë, e kryer në bashkëpunim.



BLOG PERIFERI

Z. Berisha, hidhini një sy FB të Gianni Morandit



NGA ALBA MALLEZI

vijen nga faqja 1

Kanë të dy një numër të lartë ndjekësish: Mbi 1 milion qytetarë. Por ndryshojnë shumë në përmbajtjen e vlerave që promovojnë.

Janë kryer studime rreth impaktit dhe ndikimit që kanë postimet në FB në rrethin e miqve që i lexojnë, dhe postimet pozitive, optimiste, të thjeshta, njerëzore të Gianni Morandit e rendisin atë mes personazheve më me influencë në vendin fqinj.

Nga më të mëdhenjtë, nga ata që janë në majën e 71 viteve dhe të një karriere të gjatë artistike, politike, më të rinjtë duan të dinë koncepte dhe të vërteta për jetën, për ekzistencën për të marrë më të mirën e për të kaluar një bujtje në këtë rruzullin tonë të mrekullueshëm tokësor, sa më të ëmbël e pa dhimbje. Në postimet e të madhit

Gianni Morandi këtë e gjen: që nga detaje të vogla nga jeta e përditshme në punë dhe në familje, vëmendje për natyrën, për më të brishtët e deri tek tema të rëndësishme si Presidenti apo politika e vendit. Pa ofenduar askënd dhe sidomos, pa thënë të pavërteta të qëllimshme.

Ndërsa lexoj postimet e ish-kryeministrit, janë njësoj, pa asnjë ndryshim, me disa shkrime të gazetave të pas viteve 1994 fare pranë PD-së. Vetëm se atëherë, ato shkrime të RD, 55, ishin anonime. Sot ngjajnë, janë gati njësoj me stilin, fjalitë, idetë e z. Berisha në Facebook.

Kryesisht sulme frontale mbi këdo dhe gjithçka, pa pushim. Asnjë pauzë për bukuritë e natyrës, për ndërrimin e stinëve, për retë, zogjtë. Ish-kryeministri kalon ditën në një nga zyrrat në një nga pallatet më të bukura e të larta të kryeqytetit, ku besoj, në ditë të veçanta mund të shohë sy më sy retë,

dhe Tirana që atje lart, duhet të duket një mrekulli. Por jo, të gjitha postimet janë vetëm me pamje brenda 4 mureve të mobiluara rëndë.

Thonë se një nga sekretet e të jetuarit mirë është rritja e ndjeshmërisë së njerëzve përmes bukurive të Universit. Një njeri që pëlqen natyrën, vjet, hënë, qiellin, lulet, që hyn në kontakt me to, është më i mirë, më i butë se dikush tjetër. Duke parë në sy të vërtetat e ekzistencës, duke u shkrirë me to e ka të vështirë, të pamundur të thotë të pavërteta të tjera ose mbi të tjerët.

Zoti Berisha, për fat të keq vazhdon. Me të njëjtin stil, si ai i pas humbjes se Referendumit në 1994, ku në mediat e tij shkruante për shembull që Karlo Bolino ishte "kapo" i Sacra Corona Unites dhe po ashtu, babai i Carlos, një mjek i njohur në qytetin e Lecces, që jetën e tij e kaloi mes mureve të studios dentare në Via

Oberdan, ishte "mafioz".

Të njëjtat shkrime, i njëjti stil, kaq i njohur tashmë, kaq unikal në vetvete, ka rinisur të shfaqet në gazetën 55 dhe frymëzuesi, sepse shkruasi është anonim, është fare i qartë dhe identik me stilin në FB të ish-kryeministrit Berisha. Është fare i dallueshëm.

Të pavërtetat janë punët më të shëmtuara që një njeri mund të bëjë në jetën e tij, por të pavërtetat e qëllimshme, që i serviren mbi 1 milion ndjekësve nga një 71 vjeçar, më falni, por i konsideroj si një produkt i një jete shpirtërore të varfër, të vogël e të dështuar.

Ndaj, nga rubrika ime modeste, me dëshirën që edhe në moshën 71 vjeçare, një mendje e mençur e ka mundësinë për të ndryshuar dhe për t'u përmirësuar, sygjeroj: Z. Berisha, hidhini ndonjëherë një sy FB të Gianni Morandit. Mund t'ju ndihmojë.



Evropa përballë dhe konfliktet rurale



NGA AFRIM KRASNIQI

vijen nga faqja 1

...Londër, Berlin, Vienë, Varshavë dhe deri edhe Lubjanë bilanci ditor i informacioneve që merr, jetës që bëjnë, bisedave dhe angazhimeve, është në kontrast të thellë. Në Tiranë, në Prishtinë apo në Tetovë nuk ka vend për debate profesionale dhe as për shkëmbime idesh mes elitave, nuk ka vend për tema "të mëdha" që kanë të bëjnë me të sotmen dhe të ardhmen tonë, dhe as për mjedis ku fjala ka vlerë dhe rëndësi.

Në kryeqendrat shqiptare e folura profesionale dhe qytetare shihet si bezdi, provokim, menjëherësi dhe arrogancë ndaj bisedave për të cilat shumica ndjehet e prirur dhe e përfshirë. Ja p.sh. këto ditë janari në Tiranë flitet me gjuhë rrugësh midis liderëve politikë për banda, krime, drogë, kërcënime, ku secili denigron tjetrin dhe sa më e lartë është shkalla e denigrimit aq më i suksesshëm e madhështor duhet secili lider përpara ndjekësve militantë të tij. Në një vend ku të gjithë ankohemi se janë zënë hapësirat publike dhe mungesa e infrastrukturës, politika ofron zgjidhje të vetme bllokimin e rrugës ose si alternativë,

gjobitjen kolektive të të gjithë atyre që mendojnë ndryshe. Në Prishtinë, kryeqytetin që ka nevojë aq të madhe për stabilitet, zhvillim, njohje dhe theksim të identitetit demokratik liderit politikë ofrojnë zgjidhje "shqiptare", një palë turma që sulmojnë e demtojnë zyrtarët shtetë dhe mjediset publike si të ishin pjesë të të huajt, dhe pala tjetër etiketimit kolektiv të kritikëve dhe denigrim të tyre. Në Tetovë gjithashtu, gjuha e ashpër dhe denigrimi lokal mbeten tipare politike.

Kjo praktikë shqiptare, e leximit të politikës, dhe më pas e jetësimit të saj vetëm përvëç konfliktit verbal, gjuhës së ashpër, denigrimit të tjetrit dhe trajtimit të shtetit si diçka e huaj apo e kritikës si qëndrim armiqësor, - përvëçse dëshmon krizën e thellë të demokracisë sonë, mban në këmbë dhe

ushqen një lloj kulture rurale të politikës, tipar i disa shekujve më parë për shoqëritë e civilizuara. Liderit tanë, ata që vishen me kostume luksoze dhe kalojnë ditën në rrjete sociale duke folur e përgojuar gjithçka që shohin e dëgjojnë, - më shumë se misionarë të ndryshimit dhe evropianizimit ngjasojnë me modelet rurale të bajraktarit arrogant, qëllimi i të cilit është dhe mbetet sundimi absolut dhe personal. E gjithë kjo energji që harxhohet në politika të tilla ditore, pa sens dhe përmbajtje, pa rezultat dhe pritshmëri, nëse do ishte përdorur për të kundërtën, - për reforma dhe qëllime publike, me siguri që do të kishte siguruar Shqipërisë dhe shqiptarëve një pozitë shumë më komode sesa dënimi shekullor i vendit të fundit.

Imagjini nëse liderit politikë të Ti-

ranës takohen rregullisht çdo muaj për të folur për sfidat e përbashkëta të reformave dhe integritimit, imagjino nëse liderit politikë të Prishtinës kalojnë një ditë në muaj duke dëgjuar mendimin e tjetrit përballë, imagjino nëse liderit politikë të Tetovës do të ndodhte të shiheshin diku në qytet duke biseduar në një kafe pune! Ajo që tek ne është imagjinatë në fakt është normë mendimi dhe sjelljeje në çdo demokraci funksionale dhe shoqëri të kulturuar. E kundërta, refuzimi i imagjinatës dhe bashkëjetesa me rutinën e konflikteve rurale është dhe mbetet një pengesë thelbësore për progresin shoqëror, politik dhe ekonomik.

Kontrasti i kësaj sjelljeje bëhet edhe më i madh kur liderit e çdo ane politike gjithçka që bëjnë e justifikojnë në emër të interesit publik, shpëtimin, integritimit dhe bashkimit të Shqipërisë me Evropën. Ata gabimisht mendojnë se Evropa shqiptare është e destinuar të jetë e njëzuar në emrin, portretin dhe mandatin e tyre personal politik, se fatet e mëdha përfaqtohen nga fati i tij politik, dhe kështu, projektin e vet politik e imponojnë si zgjidhje e vetme në interes të vendit e qytetarëve. Ata refuzojnë të pranojnë se vetë ky fakt, njësimi i tyre personal me fatin, vendin, interesin publik, Evropën dhe të ardhmen, është abuziv, irreal dhe tregues i një sistemi mendimi që nuk ka asnjë lidhje organike me vlerat e vërteta të demokracisë.

Duke aplikuar konflikte permanente rurale, duke imituar modelet negative brenda nesh, dhe duke kërkuar të formojnë turmat e tyre besnike, përvëç të tjerash ata na mohojnë shansin të kemi qoftë edhe një model referimi pozitiv, një moral moral prej

të cilit të mësojnë të tjerët dhe ku qytetarët të mbajnë gjallë shpresën e ndryshimit të nesërm. Mungesa e këtij modeli moral pozitiv e pamundëson ndikimin pozitiv të Tiranës politike në konfliktin rural në Prishtinë e Tetovë dhe anasjelltas, ndërhyrjen e Prishtinës apo Tetovës politike në konfliktet rurale të Tiranës. Për pasojë, jo vetëm se në çdo rast zgjidhja pritet nga jashtë, faktori shqiptar dobësohet, privohemi nga modelet pozitive por edhe si qytetarë e shoqëri shfaqemi ashtu siç nuk duhet të jemi, - dukshëm larg standardeve, sistemit të vlerave dhe praktikave demokratike të modelit evropian në të cilin prej mëse dy dekadash gënjëjmë votuesit se duam të integrohemi.

Zgjidhja e krizave të identitetit politik nuk vjen përmes skenarit të eliminimit politik të tjetrit, as nga praktikat e injorimit të mendimit ndryshe, as nga kauzat e mëdha që përfundojnë në shi gurësh mbi shtetin tënd, as nga kultura e gjakmarrjes së përjetshme në politikë. Zgjidhje nuk janë as importimet e formulave populiste apo aksidentale si në ndonjë vend fqinj, as pritshmëria se sëmundjet shërohen me kohën dhe as zbarkimi në Tiranë, Prishtinë e Tetovë çdo 3 muaj i ndonjë negociatori të huaj. Zgjidhja mbetet e kundërta, - ilja prej këtyre praktikave dhe sjelljeve për t'u dhënë jetë fjalës, kritikës, mendimit, dialogut, transparencës, përgjegjësisë. Suksesi në politikë nuk matet asnjëherë me ditët, muajt, vitet apo dekadat që qëndron në pushtet, që sdon të tjerët, por me aktet, gjurmët, sjelljet dhe produktet konkrete ndaj qytetarëve, shtetit, shoqërive dhe sfidave të tyre. Duke e harruar këtë, palët vendimmarrëse politike po lexojnë mësimin e gabuar, dhe në fund, duke e ngritur në sistem mësimin e gabuar ata po provojnë tezenë se kush qeveris periferinë sdon, por asnjë rrugë e periferisë dhe kultura rurale nuk të ndihmon të arrish Evropën e vlerave, - projektin e munguar të shqiptarëve.

Aksident në Dajt, vdes vëllai i presidentit të 'FK Tirana'

Mjeti 'Range Rover' i Agron Halilit doli nga rruga

Ekstradimi

Roma dorëzon beratasin e dënuar për vrasje



Ekstradohet nga Italia, drejt vendit tonë, një person i shpallur në kërkim ndërkombëtar për "Vrasje me paramendim". Edvid Ndile, 46 vjeç, banues në Berat, ishte shpallur në kërkim pasi, Gjykata e Rrethit, me vendimin Nr. 82 datë 21.06.2002 e ka dënuar me 17 vjet burg për Veprën Penale të "Vrasjes me paramendim". Në prill të vitit 2001, Ndile ka qëlluar me armë zjarri drejt një automjeti ku udhëtonin tre persona. Për pasojë ka gjetur vdekjen shtetasi G.R. Si rezultat i bashkëpunimit me Interpol Romën, u bë i mundur arrestimi, me qëllim ekstradimin drejt vendit tonë.

NIKOLETA KOVAÇI
TIRANË

Dy aksidente me pasojë vdekjen janë shënuar ditën e djeshme në vend, ku për pasojë kanë humbur jetën dy persona. Në mëngjes një grua është gjetur e pajetë në anë të rrugës nacionale në vendin e njohur si "Krye Bushat", ndërsa është dashur ekspertiza mjeko-ligjore që të përcaktojë shkakun e vdekjes së gruas, pasi autori ka mundur të largohet dhe nuk është identifikuar ende. Disa orë më vonë, në Tiranë, humbet jetën një tjetër person, ndërsa mjeti i tij ka dalë nga rruga në fshatin "Tujan" të Tiranës nuk përfunduar në humnerë. Është dashur ndërhyrja e mjeteve të rënda, për të bërë të mundur nxjerrjen



Makina e Agron Halilit

Dje
Dy aksidente, në harkun kohor të pesë orëve janë shënuar ditën e djeshme në Shkodër dhe Tiranë, ku janë shënuar dy viktima. Policia vijon hetimet për rastet



Vendi i ngjarjes

trupi të pajetë, ndërsa është mësuar se viktima kishte mbetur Agron Halili, nga Tirana, 52-vjeç. Burri, i cili ishte edhe vëllai i presidentit të 'FK Tiranës' ka qenë duke udhëtuar i vetëm.

NGJARJA SIPAS POLICISË

Orëve të mesditës së djeshme policia bën me dije se është sinjalizuar për një aksident të rëndë automobilistik, ku një mjet kishte

përfunduar në greminë. Më tejherë në drejtim të vendit të ngjarjes janë nisur forcat policore, por ndërhyrja ka qenë e pamundur pa mjetet e posaçme. Sipas të dhënave të policisë 52-vjeçari, Agron

Halili, humbi kontrollin e makinës tip 'Range Rover' duke përfunduar në humnerë. Halili udhëtonte i vetëm në makinë dhe se ndërroi jetë rrugës për në spitalin e Traumës. Për të nxjerrë trupin e tij nga makina është dashur ekskavatori për shkak të dëmtimeve të shumta që kishte marrë mjeti dhe mbulimit nga gurët shkëmborë që karakterizojnë zonën. Policia Rrugore sqaroi se aksidenti ka ndodhur në aksin rrugor Komuna Dajt-Tiranë në zonën e njohur si "Tujan", tekua Agron Halili kthehej drejt Tiranës. Hetimet për ngjarjen kanë nisur, ndërsa shkak paraprak i aksidentit dyshohet kushitet e këqija atmosferike, që kanë nxjerr nga rruga mjetin me të cilin udhëtonte i vetëm Halili. Ngjarjen po e hetojnë edhe ekspert-autoteknikë, për të mësuar shkakun real të daljes nga rruga të Halilit.

Teuta®

ORIZ GOLD
PREMIUM QUALITY

LOTTO
BASMATI
CARNAROLI
PARBOILED

Një Mbretëreshë për mikeshë...

Lagjia 15, Rruga "Aleksandër Goga", Durrës- Shqipëri (Albania) Tel.: 052 223094 Fax: 052 22537
Info@teutadurrës.com www.teutadurrës.com

Maskat grabisin më armë kinezët e kromit të Bulqizës

 **Banda**

Italia dënon grupin e hajdutëve shqiptarë



■ Karabinierët italianë, në periudhën tetor-nëntor 2014 arrestuan 5 shqiptarë për një seri vjedhjesh të kryera në zonën e Savonës. Më 29 janar 2015 gjykata dha dënimet përkatëse për bandën e hajdutëve shqiptarë. Behar Kaleci, 24 vjeç, pas gjykimit të shkurtuar u dënua me 21 muaj burg dhe 600 euro gjobë. Bernard Cakoni, 27 vjeç, u dënua me 18 muaj burg dhe 600 euro gjobë, Drlon Leçi, 21 vjeç u dënua me 6 muaj burg dhe 600 euro gjobë, Aldor Ceka, 29 vjeç u dënua me 20 muaj burg dhe 800 euro gjobë, ndërsa gjyqi i Floriant Toçit, 23 vjeç u shty për në muajin shkurt.

Policia zbardh ngjarjen, kinezët u përleshën me maskat

NIKOLETA KOVAÇI
TIRANE

Policia e Dibrës ka mundur të vërë në pranga dy persona të cilët rezultojnë të jenë autorë të një ngjarjeje të rëndë të shënuar mbrëmjen e së enjtes në Bulqizë. Dy të rinj, iu kanë zënë rrugën tre kinezëve, të cilët po ktheheshin nga qyteti ku edhe kishin bërë pazarin. Të huajt mësohet se janë të punësuar në minierat e kromit dhe në momentin që janë përballur me maskat, ata kanë pretenduar t'i shmangin duke u përleshur. Por dy të rinjtë kanë qenë të pajisur edhe me një kallashnikov, ku nën kërcënimin e tij kanë mundur të iu marrin të gjitha paratë që kanë patur me vete dhe materialet që kishin blerë. Policia ka ndërhyrë në një operacion të shtrirë në disa zona dhe ka mundur të sjellë

Ngjarja
Dy grabitësit, Selim Rushiti, 23 vjeç, dhe Edison Daka, 21 vjeç, u kanë kërkuar të dorëzojnë menjëherë gjithçka kishin me vete, të holla dhe sendet që kishin blerë në dyqan



Përleshja
Kinezët janë përleshur me dy të rinjtë e maskuar dhe me armë por kur grabitësit kanë nxjerrë kallashnikovin, atëherë ata janë 'dorëzuar' duke iu dhënë gjithçka kishin

në pranga dy të dyshuarit, të cilëve iu gjet arma e krimi si dhe mallrat që iu kishin grabitur kinezëve.

POLICIA
Sipas të dhënave që vijnë nga policia bëhet me dije se dy persona nga Bulqiza janë

arrestuar nga policia pasi të maskuar dhe të armatosur, kanë grabitur tre kinezë që punojnë në minierën e kromit.

Gjatë orës 19:00 të ditës së enjte tre shtetasit kinezë kanë zbritur në qendër të qytetit për të blerë mallra konsumi. Në momentin kur ata janë kthyer për në minierë, janë përballur me dy persona të armatosur dhe të maskuar. Dy grabitësit, Selim Rushiti, 23 vjeç, dhe Edison Daka, 21 vjeç, u kanë kërkuar të dorëzojnë menjëherë gjithçka kishin me vete, të holla dhe sendet që kishin blerë në dyqan. Madje, mes palëve ka nisur dhe përleshja fizike. Grabitësi që mbanin me vete një armë tip kallashnikov iu kanë marrë rreth 100 mijë lekë të vjetra dhe sendet personale. Pas denoncimit në polici, shumë shpejt është bërë operacioni për kapjen e dy grabitësve. Gjatë arrestimit, dy shtetasve u është gjetur dhe arma automatik me të cilën dyshohet të jetë bërë grabitja. Dy të rinjtë tashmë do të hetohen edhe për ngjarjet të tjera të ngjashme.

BARI dhe BRINDISI

nga € 29*

LA COMODITA' CHE CERCAVI

Fluturime direkte nga **Tirana**
çdo të Hënë, të Mërkurë e të Premte

*duke filluar nga € 29 për segment, taksa e bagazh përfshirë, vende të limituara.

+355 42 251837

për informacione e prenotime

Na ndiqni në  
www.balkanexpress.it

Balkan
express

Surja	Shehu	Remzi	X	X	Demokrat	Vasho	Koli	X	X	Mustafa	Leka	Muharem	X	X	Kol	Sufaj	Gjelosh	X	X
Kristo	Zharkali	Tofi	X	X	Çezim	Kali	Fadil	X	X	Rukie	Mehmetaj	Ram	X	X	Alaj	Karamesho	Kosta	X	X
Mehmet	Shuli	Avdi	X	X	Beqir	Xhepa	Ramazan	X	X	Tomor	Merini	Merin	X	X	Fahrudin	Jaka	Rifat	X	X
Grigor	Todi	Llazi	X	X	Shkëlqim	Abazi	Mylym	X	X	Nis	Dika	Fejzi	X	X	Dino	Jaka	Safet	X	X
Ilirjan	Tugu	Mehmet	X	X	Ruzhdi	Peniku	Shaban	X	X	Kristo (Gilbert)	Bidoshi	Vangjel	X	X	Soitraq	Bumbili	Jani	X	X
Shuk	Babona	Kole	X	X	Dhimitër	Stefo	Nikola	X	X	Pavlo	Lako	Dhimitër	X	X	Sulejman	Mamica	Islan	X	X
Luan	Mugollari	Xhelal	X	X	Pellumb	Papapani	Muharem	X	X	Rifat	Lashi	Sali	X	X	Klaudio	Deka	Aleksander	X	X
Veip	Hoxha	Ferik	X	X	Shpëtim	Nazifi	Jahje	X	X	Vasil	Dhimesh	Dhiron	X	X	Theofan	Nikola	Thodor	X	X
Kristo	Suba	Aslan	X	X	Xhevdet	Dutaj	Qamil	X	X	Llazo	Glavoç	Oro	X	X	Shkëlqim	Zeca	Hamdi	X	X
Çezar	Sule	Donir	X	X	Adriatik	Çela	Zini	X	X	Lavdim(vasi)	Çipi	Sel (theodor)	X	X	Befije	Ilia	Parapet	X	X
Dëshir	Çezar	Facil	X	X	Çezar	Kaskaviq	Thanas	X	X	Agim	Zana	Dine	X	X	Dhimitraq	Stervo	Kosta	X	X
Lazer	Shkurtaj	Ndrek	X	X	Viktor	Vershaja	Zef	X	X	Shkëlqim	Zana	Dine	X	X	Sulejman	Shahini	Hamit	X	X
Hasan	Basha	Barjam	X	X	Xhelal	Malecoç	Met	X	X	Abdulla	Berberi	Hyjni	X	X	Zhaneta	Vahko	Kristaq	X	X
Vasil	Jano	Nikola	X	X	Thelencza	Hoxha(kuq)	Adem	X	X	Filip	Janita	Foto	X	X	Silvana	(Pisaco)	Kristaq	X	X
Mihal	Kapsalidi	Jorgo	X	X	Fatmir	Korani	Fam	X	X	Nehdan	Nehdan	Kolaci	Hasan	X	Prek	Paja	Pjetush	X	X
Kosta	Rizo	Jani	X	X	Agim	Dobruna	Adem	X	X	Sabri	Hoxhaj	Nuredin	X	X	Mekulle	Frashëri	Qemal	X	X
Irfan	Sullitari	Sulejman	X	X	Jorgo	Orjazi	Kristo	X	X	Tahir	Hoxhaj	Shaban	X	X	Hekuran	Çaushtaj	Barjam	X	X
Abdyll	Dulla	Uk	X	X	Flamur	Karagjozi	Neshtet	X	X	Kristaq	Kote	Çezar	X	X	Bepin	Orosi	Pjetër	X	X
Xhevdat	Gjina	Barth	X	X	Risto	Shegani	Gjorgji	X	X	Ismet	Selima	Jashar	X	X	Pjetër	Prendi	Kole	X	X
Gjovani	Kole	X	X	Get	Doda	Nikolë	X	X	Nori	Nori	Lila	Gjon	X	X	Ejll	Brupaj	Pashko	X	X
Hasr	Hijak	Syl	X	X	Faruk	Reka	Malq	X	X	Hajri	Qemalaj	Kanan	X	X	Gëzim	Ferizaj	Oqazim	X	X
Riza	Bregu	Zenel	X	X	Sezai	Turku	Hyjen	X	X	Xhevdat	Ouku	Jakup	X	X	Kosta	Kapsalidi	Jorgo	X	X
Mynevar	Zairi	Hyjen	X	X	Kostaq	Nano	Nikolaq	X	X	Mehdi	Prodrani	Zenel	X	X	Josif	Todi	Vasil	X	X
Ndue	Nlaj	Luc	X	X	Musafa	Icazi	Demro	X	X	Sali	Zenelaj	Milako	X	X	Agim	Noku	Njysim	X	X
Vladimir	Biba	Grigor	X	X	Abdulla	Sirani	Osmen	X	X	Nevus	Kulla	Mehmedi	X	X	Niko	Heseni	Rip	X	X
Xhaver	Elezi	Bislim	X	X	Mho	Cjri	Kogo	X	X	Nuhi	Kastrati	(kole)	Qazim	X	Barjam	Xbraku	Ali	X	X
Preng	Gjaci	Bib	X	X	lio	Stigani	Vasil	X	X	Mehmet	Dapeli	Niaz	X	X	Fatos	Hoxha	Xhelal	X	X
Bashkim	Demalaj	Shpend	X	X	Ram	Aliaj	Sadik	X	X	Koç	Myrtaj	Skëndo	X	X	Roland	Ndreka	Vasil	X	X
Sadik	Rexhaj	Murat	X	X	Pepo	Kagjini	Leonida	X	X	Galjana-Ana	Ajaz	Jashar	X	X	Zyhd	Koni	Tahir	X	X
Shemsi	Ripi	Arap	X	X	Marko	Krabi	Gjon	X	X	Arjan	Alvora	Fadil	X	X	Petro	Samara	Shytiqiri	X	X
Sander	Gega	Nishe	X	X	Musa	Kolqi	Dasho	X	X	Kole	Margjini	Gjon	X	X	Mina (Minella)	Plaku	Nuri	X	X
Mare	Tiraj	Fran	X	X	Muhamet	Karskashi	Shahin	X	X	Aslan	Shima	Ibrahim	X	X	Pavlin	Gjoka	Pjetër	X	X
Niko	Ajdhoni	Dhimitër	X	X	Fatmir	Mujo	Sefir	X	X	Albert	Asheni	Ahmet	X	X	Spartak	Nigela	Kico	X	X
Bashkim	Hanuni	Xhyther	X	X	Vasil	Kumbuli	Thoma	X	X	Ruzhdi	Kraja	Selman	X	X	Ilirjan	Gelaj	Elez	X	X
Abedin	Hoxha	Zenel	X	X	Albert	Pirazi	Mustafa	X	X	Tomë	Kaloku	Zef	X	X	Besnik	Çajaj	Çelo	X	X
Arjan	Gjergji	Llesh	X	X	Smajl	Kopleri	Riza	X	X	Mitat	Lika	Shitaj	X	X	Eviser	Luli	Mezan	X	X
Hasan	Spahiu	Bislim	X	X	Harilaco	Gjuri	Kesko	X	X	Nikolin	Lushi	Zef	X	X	Yhi	Toro	Brham	X	X
Oemal	Omuri	Ramadan	X	X	Namir	Staravecka	Xhelal	X	X	Agim	Gjoka	Jonus	X	X	Dod	Dyla	Mark	X	X
Zenel	Ukperaj	Bislim	X	X	Barthyl	Sagari	Ali	X	X	Avni	Aziz	Seht	X	X	Veron	Duma	Hasan	X	X
Reshat	Xhindioli	Asim	X	X	Shiqere	Kermaja	Ram	X	X	Nikolla	Ndreu	Vangjel	X	X	Koço	Ultrimi	Vangjel	X	X
Aleks	Çami	Saban	X	X	Reshat	Xhemali	Xhemal	X	X	Myrtar	Taka	Hasan	X	X	Ali Riza	Oseku	Barjam	X	X
Marie	Zogji	Kol	X	X	Dhimitër	Ceko	Vasil	X	X	Seit	Ahmetaj	Hatem	X	X	Fabjan	Kati	Vangjel	X	X
Vasil	Çoku	Koleç	X	X	Nazmi	Denishi	Shytiqiri	X	X	Ilir	Dibra	Lic	X	X	Arben	Driza	Zani	X	X
Behardin	Kodra	Sabri	X	X	Vangjel	Gegaj	Kristo	X	X	Skender	Shkëmbi	Abdyll	X	X	Ritvan	Driza	Zani	X	X
Spiro	Gjokopuli	Vasil	X	X	Spiro	Dino	Kristo	X	X	Ymer	Armasi	Ramadan	X	X	Naim	Dymshiti	Zyfi	X	X
Zyhd	Scheer	Smajl	X	X	Medi	Lula	Demir	X	X	Kastrokocja	Barthi	(Marko/mark)	X	X	Ismail	Gjini	Ali	X	X
Themistokil	Çule	Niko	X	X	Ndrek	Bicaku	Kol	X	X	Simon	Mirakaj	Pal	X	X	Jeko	Funthi	Mehmet	X	X
Ndue	Ndoci	Gjon	X	X	Islam	Haxhij	Mytar	X	X	Sokol	Mirakaj	Pal	X	X	Alez	Hoxha	Uke	X	X
Seit	Xhomaqaj	Zenel	X	X	Hajrulla	Krija	Can	X	X	Artur	Hoxha	Ferd	X	X	Estret	Kodra	Besim	X	X
Sofokli	Lulo	Kipo	X	X	Imedi	Biba	Idris	X	X	Lazer	(Shkëmbi)	Zef	X	X	Dituri	Hoxha	Xhemal	X	X
Ibrahim	Xhoxho	Hyjen	X	X	Imi	Çolaku	Shytiqiri	X	X	El hem	Himelisi	Dalp	X	X	Hyjen	Çela	Sulejman	X	X
Shpëtim	(Hoxha)	Dalip	X	X	Rat	Çobaj	Sadik	X	X	Myrteza	Barjokaj	Fahri	X	X	Arben	Ndile	Thodor	X	X
Fevri	Doko	Nexhip	X	X	Tajar	Vendresha	Selman	X	X	De	Shkëmbi	Brak	X	X	Bejkush	Veli	Hasim	X	X
Rustem	Shahaj	Bazo	X	X	Mizat	Kuka	Lahe	X	X	Vlako	Bravolaj	Gjorgji	X	X	Man	Hoxhaj	Xhemal	X	X
Behar	Aslanaj	Neki	X	X	Oriz	Hamit	Çani	X	X	Tomir	Dema	Gaspër	X	X	Preng	Tosku	Frmk	X	X
Spiro	Mengjez	Vangjel (vang)	X	X	Qeset	Margjani	Telemak	X	X	Israni	Sal	Mark	X	X	Behije	Hajdari	Xheladin	X	X
Hasan	Boshnjaku	Beqir	X	X	Brahim	Guri	Shaban	X	X	Gjergj	Ndoka	Mark	X	X	Mark	Pamati	Zef	X	X
Ramadan	Kaloshi	Mehmet	X	X	Dede	Kasned	Mark	X	X	Ohdishe	Çollu	Kosta	X	X	Ridvan	Sokolli	Daut	X	X
Shpëtim	Nisrati	Hakik	X	X	Avduraman	Kreshpa	Ramadan	X	X	Kujtim	Demiraj	Rapo	X	X	Ruzhdi	Vogji	Selim	X	X
Skander	Marku	Hakik	X	X	Xhemaj	Dermishaj	Tahir	X	X	Fran	Shkëmbi	Kol	X	X	Doçe	Vedaj	Lulash	X	X
Skander	Marku	Hakik	X	X	Mal	Melalaj	Xhemal	X	X	Karim	Mydri	Selim	X	X	Zyber	Selmsj	Abzi	X	X
Ded	Miri	Pjetër	X	X	Sali	Peca	Selman	X	X	Nikoll	Haxhi	Prek	X	X	Ramiz	Shehu	Riza	X	X
Neim	Pashaj	Bejo	X	X	Roland	Bollano	Thodor	X	X	Aslan	Mustafa	Adem	X	X	Foto	Bilsha	Hanla	X	X
Kristaq	Çami	Vasil	X	X	Maksim	Bollano	Koço	X	X	Arben	Janko	Tasi	X	X	Gjon	Kanda	Tahir	X	X
Agron	Çankja	Qamil	X	X	Thoma	Rokaj	Xhyter	X	X	Spiro	Birgo	Zaho	X	X	Spasro	Nikola	Kipo	X	X
Hyjet	Letija	Qazim	X	X	Nikas (Nihar)	Myrte	(Myrte)	Rifat	X	Islam	Gjomajaj	Muse	X	X	Minuk	Broshaj	Shylen	X	X
Arben	Franga	Ndue	X	X	Abedin	Çunaj	Barjam	X	X	Jani	Kola	Lio	X	X	Gani	Hoxhallari	Qamil	X	X
HAUDAR	FREGJAL	ZENEL	X	X	Emin	Shehu	Ramadan	X	X	Lame	Çela	Hekuran	X	X	Artan	Murta	Abdulla	X	X
Arjan	Mullali	Ridvan	X	X	Sotraq	Vangjel	Mit	X	X	Pavli	Piro	Lame	X	X	Maksud	Hablaj	Limon	X	X
Arjan	Shabanaj	Shkënder	X	X	Robert	Rado	Andrea	X	X	Roftap	Dautaj	Daut	X	X	Raf	Elez	Revhaj	X	X
Ali	Bucpapaj	Isht	X	X	Ferhat	Ferhati	Ramazan	X	X	Ferdush	Focmi	Çezar	X	X	Ilir	Shahinaj	Tofik	X	X
Kaplan	Resulij	Xhano	X	X	Sami	Kodralu	Ramazan	X	X	Fotaj	Babi	Gaj	X	X	Xhevdat	Pashaj	Muharem	X	X
Mustafa	Xbraku	Ali	X	X	Kristaq	Mihalari	Nikola	X	X	Fotaj	Babi	Gaj	X	X	Anton	Vokri	Luigj	X	X
Asrit	Rama	Aslan	X	X	Ibrahim	Budini	Shahin	X	X	Falosh	Menushaj	Ramis	X	X	Feta	Hasi	Sade	X	X
Ibrahim	Aliaj	Uk	X	X	Andrea	Gjinerari	Koço	X	X	Terzina	Krasniq	Kolë	X	X	Mehmet	Gouhaj	Adem	X	X
Kristaq	Jorgopoulos	Dhimitri	X	X	Shkëlqim	Shahin	Siro	X	X	Agim	Agjllaj	Ali	X	X	Mujo	Çela	Sheif	X	X
Vasil	Kokali	Stavro	X	X	Selki	Potlogica	Hamdi	X	X	Beqir	Aliaj	Ali	X	X	Barjam	Kolajaj	Han	X	X
Agron	Koshi	Rauf	X	X	Muhamet	Velja	Musa	X	X	Leze	Shkurtaj	Simon	X	X	Kujtim	Duri	Pandi	X	X
Ernest	Piklini	Mark	X	X	Leze	Shkurtaj	Simon	X	X	Foti	Gjoni	Adem	X	X	Vah	Fusha	Ramazan	X	X
Nuredin	Bresho	Megan	X	X	Ferhat	Ferhati	Ramazan	X	X	Danish	Meta	Shaqir	X	X	Jorgji	Gerazi	Leksi	X	X
Petro	Hirna	Sajram	X	X	Robert	Rado	Andrea	X	X	Arefi	Latollari	Ahmet	X	X	Haim	Kup	Rasim	X	X
Ndoci	Peci	Narash	X	X	Kristo	Xexo	Tushi	X	X	Kristo	Xexo	Tushi	X	X	Hario	Bila	Dhimitri	X	X
Fejzi	Alcizi	Riza	X	X	Ylson	Molla	Nuri	X	X	Demir	Murtezaj	Anf	X	X	Abis	Çoça	Isht	X	X
Fejzi	Alcizi	Riza	X	X	Zef	Doçi	Kolë	X	X	Arif	Nezaj	Demush	X	X	Liman	Koloci	Seladin	X	X
Fijrije	Oshafi	Azem	X	X	Mitar	Vellu	Esat	X	X	Kostandin	Shufi	Ndrek	X	X	Ilir	Haskirj	Neohat	X	X
Hajdar	Shkurtaj	Brahim	X	X	Thoma	Parshaj	Ishtaf	X	X	Abdyll	Shabaj	Çani	X	X	Xhemal	Meskaj	Aslan	X	X
Agim	Ymeraj	Zaim	X	X	Slefan	Kola	Jorgo	X	X	Beqir	Aliaj	Ali	X	X	Nazmi	Keç	Aslan(aslan)	X	X
Leonard	Skabona	Nikolë	X	X	Selim	Jusufi	Zenel	X	X	Kostandin	Sadri	Malmaja	Avni	X	Nik	Gega	Prendush	X	X
Sadi	Koloci	Adem	X	X	Poliskeni	Stefani	Perikli	X	X	Arif	Nezaj	Demush	X	X	Rexhep	Ibrahimi	Ibrahim	X	X
Vasilqaj	Andoni	Hanilë	X	X	Nevezat	Geta	Izet	X	X	Zyhd	Topi	Shaban	X	X	Viron (viro)	Andoni	Sokrat	X	X
Jemrin	Bejko	Myrteza	X	X	Pjetër	Përgjoka	Ndue	X	X	Dhimitri	Adranjaj	Anesti	X	X	Gjergji	Bici	Nikolë	X	X
Ilia	Stavro	Jani	X	X	Haziz	Kulloli	Musa	X	X	Pjetër	Kuçaj	Zef	X	X	Hari	Zhegu	Gani	X	X
Vilson	Zeko	Egertem	X	X	Hilmi	Dellu	Haxhi	X	X	Pëllumb	Kuçaj	Zef	X	X	Shaban	Naraj	Beqo	X	X
Beqir	Ibraj	Dan	X	X	Nebi	Dohaj	Lymo	X	X	Edmond	Derishi	Besim	X	X	Barjam	Vora	Kesem	X	X
Sali	Tagani	Hirap	X	X	Dele	Safu	Isuf	X	X	Islam	Shera	Qamil	X	X	Xhemal				

»» SPECIALE

Në librin e ri me titull "Gjysëm shekulli me pendë në dorë", libër që i shtohet kolanës së veprave të Mustafa Krujës, e që pritet të dalë në librari këto ditë, gjendet edhe ky shkrim për kujtimor i Mustafa Krujës mbi vrasjen e Hasan Prishtinës në Selanik, i përkthyer dhe i përgatitur nga Prof. Izber Hoti me titullin "PROMEMORJE E DENJË". Në shkrimin paraqitës të këtij dokumenti profesori nga Prishtina jep ndër të tjera edhe të dhëna arkivore dhe historike rreth shkrimit të kësaj promemorie nga Mustafa Kruja, kushtuar ngjarjes së bujshme të vrasjes së Hasan Prishtinës në Selanik. Prof. Izber Hoti shkruan ndër të tjera: "Atentati i paskrupullt mbi patriotin Hasan Prishtina, pa dyshim e shqetësoi shumë edhe këtë intelektual të rrallë të kohës. Shqetësimin e vet për një humbje kaq të madhe të popullit shqiptar Mustafa Kruja do t'a shprehë hapur në një shkrim të përgatitur për botim (s'dihet u botua apo jo), që gjendet në Arkivin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Italisë në Romë (fondi Shqipëria, kutia nr. 24, fasc.5, dok.nr. 94). Përkujtimi i Mustafa Krujës për Hasan Prishtinën është i shkruar në gjuhën italiane me makinë shkrimi dhe nuk ka datë as kurrfarë të dhënash shoqërore,

veç nënshkrimi të autorit. Mirëpo, mbështetur në përmbajtjen e kësaj promemorie shihet qartë se ajo është shkruar në vitin 1933, pra menjëherë pas vrasjes së Hasan Prishtinës, ndërsa mbështetur në faktin se ky material arkivor gjendet në mes të materialeve të tjera të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Italisë, vërteton interesimin e kësaj ministrie për jetën dhe veprimtarinë e dy të përmendurve, veçanërisht këtij të fundit. Duhet theksuar se të dhënat për qëndrimin e Hasan Prishtinës në Itali, marrëdhëniet e tij e të Dervish bej Mitrovicës me D'Anuncion janë objektive, por këto nuk mjaftojnë që këto personalitete të konsiderohen italo-filë, siç përpiket t'i paraqesë Mustafa Kruja. Megjithatë, as ky vlerësim as edhe disa të tjera të mundësme, nuk ndikojnë në vlerën e pakontestueshme të këtij përkujtimi. Pasi ky përkujtim u përgatit për shtypin italian, Mustafa Kruja atë e shkroi në gjuhën italiane, prandaj ai u shqipërua dhe do të botohet në tërësi, por i shoqëruar me disa ndërhyrje të domosdoshme." Më poshtë po e sjellim të plotë këtë promemorie të hartuar nga Mustafa Kruja sipas përkthimit dhe redaktimit të prof. Izber Hotit.



MUSTAFA KRUIJA
TIRANE

HUMBJA E NJË ATDHETARI TË MADH-HASAN BEJ PRISHTINA

Më 15 gusht të vitit në vijim kronikës së përherëshme të gjakut të Ballkanit, shtypi evropian i shtoi edhe një fakt të përgjakun. Ish Kryetari i Këshillit Shqiptar (Komitetit Kombëtar për mbrojtjen e Kosovës I.H.) u vra në një rrugë të Selanikut prej një shqiptari tjetër.

Shtypi grek u zemërua dhe kundërshtoi. Për origjinën dhe për shkaqet e këtij atentati ai bëri komente pak a shumë të drejta. Shtypi serb nuk mundi të përmbahet dhe haptazi shprehu kënaqësi dhe festoi, duke parë se u vra një armik i shtetit të tij, të cilin e konsideronte mjaft të rrezikshëm.

Në gazetën italiane informatat për vdekjen e Hasan Prishtinës thuhet se nuk u shoqëruan fare me kurrfarë komentesh për një mik të ardhshëm, ndoshta pse ai nuk pati mundësi të tregonte me ndonjë fakt të rëndësishëm një miqësi të tillë. (Teksti në fjali i shkruar në origjinal me makinë u korrigjuar e u plotësua me laps disa herë. (I. H.) Mirëpo, un jam i sigurtë se pas njohjes së biografisë së tij opinioni italian do të vajtojë dyfish: për një atdhetar të madh, bir i devotshëm i një vendi që është lidhur aq ngushtë me Italinë, me interesa dhe me ndjenja të përleshkëta, si edhe për një mik besnik të saj.

Duke u përpjekur pra, të ndriçojmë figurën e Hasan Prishtinës në shtyllat e një organi të opinionit publik italian, jam i bindur se do t'i shërbejmë jo vetëm emrit të njohur të një mikut tim dhe bashkatdhetari të humbur, por edhe të këtij opinioni.

Për t'a njohur mirë personalitetin, karakterin, veprën dhe ndjenjat e Hasan Prishtinës duhet të kthehemi 25 vjet prapa, dmth. në fillim të jetës së tij politike.

JEMI PRA NË VITIN 1908.

Një i ri shqiptar, para së gjithash i ri për nga shpirti, energjia dhe impulsi, sapo kishte filluar karrierën e tij politike si deputet në Parlamentin e Perandorisë Osmane, që revolucionin i Osmanëve të rinj (xhon turqve) e kishte nxjerrë nga varri, ku e kishte varrosur një kohë të shkurtër porsa kishte ardhur në fron Abdyl Hamiti II. Ai në këtë parlament shkonte për të përfaqësuar popullatën e Kosovës, e cila pasi ishte ribashkuar në Ferizaj, i dha grushtin e fundit despotizmit shekullor e të përgjakshëm të sulltanëve të Stambollit, duke i dhënë fund kundërvënive ndaj padronit perandorak mbi dyzetmilionë, shtetasve myslimanë e të krishterë, turq e jo turq. Mirëpo, Hasan Prishtina, në atë kohë 30 vjeç e i ngazëllyer mjaft nga patriotizmi, nuk e kuptonte mandatin e tij si instrument për sendërtimin e interesave shekullorë të krahinës së tij, të cilën e donte shumë me atë larmani popujsh, që quhej Perandori Osmane. Në të vërtetë ai në Parlament mbronte vetëm të drejtat e një populli, popullit të vet shqiptar, i cili ishte i shtypur, por jo edhe i nënshtruar. Perandoria Osmane me zgjedhën e saj të përgjërë përipiq

MUSTAFA KRUIJA: Dorëshkrimi italisht mbi atentatin ndaj Hasan Prishtinës

Promemoria e gjetur në arkivin e Ministrisë së Jashtme italiane mbi humbjen e një atdhetari të madh. Si e përjetoi Mustafa Kruja humbjen e mikut të tij...

që këtë popull t'a linte në errësirën e padijes me qëllim që të mos njihete të kaluarën e vet të lavdishme, që nga koha e heroit Skënderbe. Për këtë arsye populli shqiptar ishte i vetmi popull, të cilit i qe ndaluar rreptësisht, duke zbatuar ndëshkime të jashtzakonshme, të shkruante e të lexonte në gjuhën e vet, të kishte shkollat e veta. Ja pse intelektualët shqiptarë përkrähën dhe dhanë kontributin e tyre të madh për Lëvizjen e Osmanëve të Rinj, për proklamimin e Kushtetutës, e cila duhej t'u jepte dhe t'u garantonte të drejta të barabarta të gjithë popujve, të gjithë osmanëve. Shqiptarët, që në këtë kohë përbënin 80 përqind të popullsisë së territoreve të katër vilajeteve të dikurshme osmane, të Kosovës, Manastirit, Janinës e të Shkodrës, të cilët janë "pasardhësit më të drejtëpërdrejtë dhe ndoshta më të pastër të popullatës më origjinale të mbarë krahinës", shprehnin se do të mund të njohin e të mësojnë lirshëm veçoritë e tyre (kombëtare-I.H.), të kenë institutet e kulturës kombëtare, që hap pas hapi dhe pas një fati të mirë të fitojnë edhe lirinë. Mirëpo, rrugën e shqiptarëve, e fatale për Perandorinë Osmane, osmanët e rinj donin t'a pengonin me çdo kusht, duke shfrytëzuar mënyrat edhe më të

rrepta se vetë Abdyl Hamiti. Për këtë arsye shqiptarët nxituan thuhet në të gjitha qytetet e Shqipërisë, si dhe në qendrat e tjera të Perandorisë, ku gjindej një bërthamë sado e vogël e bashkatdhetarëve të tyre me entuziazëm të papërmbyjtur, të hapin shkolla private dhe çerdet e tyre kulturore. Kudo gëlonin mësimdhënësit e papritur të cilët, krahas arsimimit në ndonjë gjuhë të huaj, turke, greke ose italiane, kishin mësuar vetë dhe fshehurazi të lexonin e të shkruanin në gjuhën e vet. Në Elbasan, qendër gjeografike të territorit aktual të shtetit shqiptar, u themelua një institut mësuësish për përgatitjen e personelit didaktik kompetent. Një shoqëri kulturore, me qendër kryesore Korçën, kishte për detyrë të sigurojë mjetet e nevojshme financiare për mbajtjen e këtij dhe të institucioneve të tjera me karakter të përgjithshëm. Kongresi i posaçëm, i organizuar në Manastir, do të tumirë një alfabet thjesht latin, karshi alfabetëve të ndryshme të përdorura deri atëherë për gjuhën shqipe. Thënë shkurt, rëndësia e arsimit është çmuar mjaft si element vital për ardhmëninë e kombit të tyre. Luftëtarët për liri zgjedhën kështu rrugën e përgatitjes, por të sigurtë,

Kryengritësi

Hasan Prishtina ishte organizatori i parë i kryengritjes së madhe kosovare që filloi disa muaj para shpalljes së luftës, të cilën shtetet ballkanike e bënë kundër Turqisë e që mbaroi me çlirimin e tërë Shqipërisë veriore, duke përfshirë Shkupin nga ana e kryengritësve.



NË FOTO: Faksimile e gazetës greke ku tregohet Hasan Prishtina i vdekur ne morgun e Selanikut, dhe vrasësi Ibrahim Celu

mirëpo osmanët e rinj nuk lëshuan pe. Ata shohin qartë qëllimin përfundimtar të këtij ngazëllimi me karakter thjesht kosunar. Duke shfrytëzuar mjete e arsytetime të ndryshme osmanët e rinj filluan shtypjen në të gjitha fushat, e cila u pasua me kërcënime e intriga të llojshme, si dhe me mblylljen e shkollave dhe të çerthujve kombëtarë.

As kjo nuk mjaftoi, prandaj ata organizuan ekspedita ushtarake në të gjithë Shqipërinë, pastaj lufta të përgjakshme, varje, burgosje shumëvjetëshe, fishkëllima publike të të gjithë shqiptarëve që kishin guxim të mos mohonin gjuhën dhe kombin e tyre.

Luftëtari i ri, deputeti Prishtina (Hasan beu i takonte një familje fisnike nga Vushtrria, rreth i Prishtinës, që dikur bënte pjesë në Vilajetin e Kosovës. Me që ishte zgjedhur deputet i kësaj krahine mori mbiemrin e bashkësisë elektorale : Prishtina – shënim i autorit), ishte shumë aktiv, i palodhshëm, punëtor e luftëtar këmbëngulës, në këtë luftë të rreptë ndërmjet shqiptarëve e turqve, ndërmjet drejtësisë e forcës. Fjala, pena dhe kuleta e tij ishin në dispozicion të çështjes kombëtare. Në tribunën e Parlamentit ai është Jupiter që me gjëminin e tij u ktheu mbi kokë të gjitha vetëtimat armiqve të popullit shqiptar. Një ditë, me rastin e një interpelance për ngjarjet e përgjakshme në Shqipëri, vezirit të madh Haki Pashës, ia ktheu përafërsisht kështu : “Sikur në këtë vend të mbretëronte drejtësia për të gjithë, ju sigurisht nuk do të gjendeshit në krye të kësaj qendre ministratore, por në bankën e të akuzuarve para Portës së Lartë. Meqë këtu secili detyrohet të ndajë drejtësi sipas qejfit të vet, unë ua tërheq vërejtjen se po që se do të vazhdoni shtypjen tuaj kriminale kundër popullit shqiptar, ai do të dijë t’i mbrojë të drejtat e patjetërsuara kombëtare, kurse unë do të jem paralajmëruesi i parë i kryengritjes së tij të shenjtë.”

Dhe vërtet e mbajti fjalën. Hasan Prishtina ishte organizatori i parë i kryengritjes së madhe kosovare që filloi disa muaj para shpalljes së luftës, të cilën shtetet ballkanike e bënë kundër Turqisë e që mbaroi me çlirimin e tërë Shqipërisë veriore, duke përfshirë Shkupin nga ana e kryengritësve. Pse frutet e këtij suksesi të madh nuk qenë adekuate me sakrificat e popullit shqiptar dhe me qëllimet e Hasan Prishtinës dhe të shokëve të tij të afërt, faji duhet kërkuar vetëm te disa prijës injorantë, të cilët, të helmuar nga propaganda e korruptuar me të holla nga armiqtë e interesuar, fanatizuan masën dhe e shtynë atë të kundërshtojë kërkesën për autonominë e Shqipërisë integrale me përcaktimin e kufijve etnikë. Një propagandë e tillë mbështetej në frikën naive se shqiptarët në trojet e tyre duke vepruar kështu do të bëheshin pre e lehtë e fqinjve të pangopur. Në këtë mënyrë autonomistët me në krye Hasan Prishtinën dhe idealistin e madh Bajram Curri do të kënaqeshin me disa privilegje thjesht kulturore – administrative, pa asnjë peshë politike mbi fatin që duhej t’i takonte Shqipërisë menjëherë pas fitores së armës ballkanike mbi Turqinë.

Që Hasan beu synonte themelimin e një shteti autonom e vërteton qartë propozimi i tij, që më parë i bëri Komitetit Maqedon për të siguruar bashkëpunimin e kryengritësve

bullgarë të Maqedonisë dhe atyre shqiptarë, mbështetur në një program autonomist të një shteti shqiptar – maqedon. Ky propozim u bë zotit Pavlov, kryetar i sektorit të Shkupit të kësaj organizate dhe deputet i kësaj krahine në Parlamentin turk, me vonë ministër i plotfuqishëm i Bullgarisë pranë qeverisë së Princ Eëid-it të Shqipërisë. Mirëpo, për fat të keq,



Mustafa Kruja



Hasan Prishtina

Komiteti Maqedon e refuzoi propozimin e Hasan Prishtinës, që ishte plot mënçuri e me largpamësi politike. Gjatë Luftës ballkanike Hasan beu u gjend në tubimin elektoral në afërsi të kufirit të vjetër serb, Shkupërderdhja e ushtrisë turke, për shkak të kryengritjes shqiptare, lehtësoi shumë synimet ushtarake të armiqve të Shqipërisë. Falë këtyre rrethanave serbët përparuan rrafshëm në Kosovë. Hasan Prishtina u zu (nga forcat e armatosura serbe – I.H.). U lirua vetëm pas paqes në mes të aleatëve ballkanikë dhe të Turqisë. Pas këtij lirim Hasani erdhi në Shqipëri, duke lënë shumë pasuri në Kosovë, të cilën ia konfiskuan serbët. U kthye, pra, në Shqipërinë e lirë, të pavarur, të cilën e kishte ëndërruar, por me zemër të coptuar për shkak të humbjeve të pjesëve më të mira t’atdheut, veçanërisht të Kosovës, ku i mbetën kujtime të shumta personale e kombëtare. Përpqej t’ a ngushullonte vetveten me sendërtimin e pjesërishtë të ëndërrave të veta dhe vazhdimisht shpresonte.

Në Konferencën e Londrës nga Fuqitë e Mëdha Shqipëria u formua si principatë e pavarur e sunduar nga princi Vilhelm Eëid. Me të arritur në Shqipëri prijësi emëroi qeverinë e tij të parë e të fundit me plakun Turhan Pasha në krye. Veç Esat Toptanit, dr. Turtullit, Filip Nogës dhe Myfid bej Libohovës, në këtë qeveri bënte pjesë edhe Hasan bej Prishtina, ministër i postës dhe i telegrafit.

Në Shqipërinë Qendrore shpërtheu kryengritja reaksionare e myslimanëve fanatikë, e nxitit nga elementët e jashtëm e të brendshëm e me qëllime të ndryshme. Princi e antarët e qeverisë u detyruan t’a braktisin vendin. Mirëpo Hasan beu nuk deshi të dilte jashtë atdheut. Kishte dy muaj që lufta (e parë – I.H.) kishte marrë flakë, prandaj Hasan Prishtina mendonte se në këto rrethanat misioni i tij patriotik ishte brenda dhe jo jashtë vendit. Në limanin e Durrësit mori një proskaf italian dhe bashkë me Bajram Currin, që ishte komandant i trupave vullnetare kosovare, i shkoi në ndihmë princit dhe pavarësisë kombëtare. Që të dy të shoqëruar nga një grup nacionalistësh e nga disa vullnetarë, zbrakuan në Shëngjin. Pasi kaloi nëpër Mirditë në Hasan Prishtina u vendos në Lumë, në afërsi të Pzizenit, ndërsa Bajram Curri vazhdoi rrugën në këshqëlljen e tij, qushet Krasniqe, afër Gjakovës. Qëllimi i tyre ishte i qartë. Serbët, pushtuesit e Kosovës shqiptare, ndiqeshin nga ushtria austro – hungareze që me siguri do t’a pushtonte atë territor.

Pra, duhej vepruar në mënyrë që t’i tregojë pushtuesit t’ardhshëm, edhe me ndonjë veprim t’armatosur karakteri shqiptar i kësaj krahine. Organizohen çeta dhe Hasani sulmon kufirin serb, mori disa fshatra, përparoi me tej dhe u gjind pikërisht në muret e Pzizenit. Serbët e kuptojnë menjëherë rrezikun që u kanosej. Nëse do të lejonin që në çetat shqiptare të binte edhe një qytet i vetëm, do të shihnin si do të ngrihej e gjithë popullata e Kosovës prej Shkupi në Sanxhak, që ishte mu plani i prijësve Hasan Prishtina e Bajram Curri. Për këtë arsye serbët nxituan të bënin një ekspeditë të madhe ndëshkuese, duke rrënuar me zjarr e armë tërë ato krahina malore, që sot përbëjnë prefekturën shqiptare të pagëzuar me emrin e Kosovës, ngase nën sundimin osman ajo bënte pjesë në Vilajetin e gjërë të Kosovës. Mirëpo, ndërmarrja e këtyre personaliteteve ani pse pa ndonjë rëndësi të madhe ushtarake, arriti plotësisht qëllimin e përcaktuar politik. Me këtë veprë në të vërtetë tërhuqën vëmëndjen e Qeverisë së Vjenës dhe të Komandës Austro – Hungareze. Kështu, meqënëse tërë territori serb që i okupuar nga austriakët, Hasan Prishtina e Bajram Curri kishin besim të madh në komandën e pushtuesit dhe kështu ata arritën t’i sigurojnë krahinës së Kosovës administrim të pastër civil shqiptar në të gjitha qytetet, si dhe në shumë fshatra ku u hapën shkolla në gjuhën shqipe, që funksionuan gjatë tërë pushtimit austro – hungarez.

Nga të dhënat që u përmendën më sipër është fare e lehtë të kuptohet se Hasan Prishtina ishte një mik i sinqertë i Austro – Hungarisë. Kjo perandori i garantoi Hasan Prishtinës se po që se do të fitojë ana e saj, Shqipëria do të bashkohet në kufijtë e saj etnikë. Mirëpo, Perandoria Austro – Hungareze nga lufta e madhe doli e bërë copë e grimë. Shqipëria mbeti e vogël e cunqur, ndërsa Kosova, u dënua politike të vajtjeve nën zgjedhjen e huaj. Megjithatë, duhej shpresuar se kjo shpresë duhej të bëhej e përthshme. Edhe pse në këtë kohë u kthye gjendja e vitit 1913 nuk do të thoshte se ajo nuk mund të bëhej përtërtija e gjendjes së vitit 1916, kur u duk se fati u buzëqeshi shqiptarëve.

» 70-VJETORI

KUJTIMET kulmore nga jeta e artistit. Ndër to, historia e spektaklit të Vitit të Ri që u dha para anëtarëve të Komitetit Qendror të Partisë. Barsaleta "e gabuar" dhe batuta e Sallakut drejtuar Enver Hoxhës në sallë që e shpëtoi nga burgu

Bashkëshortja: Ju rrëfej dashurinë e rrallë me Skënder Sallakun

Vitore Sallaku: Si e sfidoi artisti postin e sekretarit të Partisë duke u martuar me vajzën e dr. L.Rashës, pushkatuar nga diktatura

DHURATA HAMZAI
TIRANE

Të dhjetëvjetori i lindjes së artistit të madh shqiptar Skënder Sallaku, pa praninë e tij, është i rëndësishëm për bashkëshorten, akrobaten e shquar shqiptare Vitore Sallaku.

Dhimbja e mungesës ndihet gjithandej. Artisti i madh i humorit, Skënder Sallaku, u nda nga jeta në moshën 79-vjeçare më 11 shkurt të vitit 2014. Ai u lind më 25 janar më 1935 në Tiranë. Skënder Sallaku u shqua si një nga aktorët më të mëdhenj të humorit gjatë gjithë karrierës së tij. Ish Kampion Kombëtar në mundjen klasike, autor skeqesh e parodish, aktivist shoqëror, ai e shkriu gjithë energjinë dhe pasionin e tij në skenë duke i falur të qeshura dhe lumturi popullit të tij. Talenti si aktor i humorit spikati që moshën 17-vjeçare, kur kryente shërbimin ushtarak. Skënderi nisi të interpretonte për Estradën e Kufirit. Pas kësaj ai bëri një kualifikim njëvjeçar në Kinë, pranë cirkut të Pekinit dhe më pas si kloun akrobat në cirk, duke dhënë një kontribut të papërsëritshëm në ecurinë e këtij profili sa të vështirë aq edhe të bukur. Por mbi të gjitha, Skënder Sallaku ishte një humorist i shkëlqyer, ku falë roleve të tij të para, u bë shtylla kryesore e Estradës së Tiranës. Në këtë institucion një kontribut të madh ka dhënë edhe bashkëshortja e tij Vitore Sallaku, akrobatja e parë e shquar shqiptare. Vitorja ka qenë shumë e lidhur me Skënderin në jetën e skenës dhe kjo lidhje nuk u ndërpre kurrë, duke e pasur më vonë Skënder Sallakun edhe bashkëshortin e saj. "Jeta për ne, nuk ka qenë fushë me lule", thotë Vitorja. Ndërsa ajo rrefën, mësojmë se vetëm një dashuri e jashtëzakonshme si ajo e Skënder Sallakut mund të sfidonte të gjitha rrethanat dhe intrigat e jetës në diktaturën komuniste ku ata jetuan pjesën më të madhe të jetës.

Zonja Vitore, kjo është ditëlindja e parë e mjeshtrit të madh të humorit, Skënder

Sallaku, që fatkëqësisht ju e festoni me mungesën e tij. Si e kujtoni lidhjen tuaj të dashurisë?

-Kujtimet e mia fillojnë kur ka ardhur Skënderi në Estradën e Tiranës. Aty jemi njohur. Skënderi ka ardhur që në 1957-n nga Estrada e Kufirit ku kishte filluar aktivitetin e tij që në



Vitore Sallaku

moshën 17-vjeçare. Në kufi bëri shërbimin ushtarak dhe aty spikati për herë të parë si artist. Madje, madje, në atë kohë thuhet se "ka ardhur një djalë nga estrada e kufirit dhe ka shumë të dhëna, shumë elemente të mira si artist". E vërtet, ai bëri që Estrada e kufirit të kishte emër, filloi të tërhiqte qaq shumë spektatorë, sa që në një shfaqje premierë atje kanë shkuar regjisorë të estradës si Besim Levonja dhe Sinan Kasapi drejtori. Ata mbetën të mahnitur kur filloi shfaqja, dhe pas saj e përgëzuan Skënderin dhe i thanë: "Skënder do të jesh një artist i madh. Mbye mend këtë fjalë që po të themi". Dhe më të vërtetë ashtu u bë. Mbase mbaroi shërbimin ushtarak, erdhi si profesionist direkt në estradën e shtetit.

Ju ishit atje në atë kohë?

-Unë kam qenë që e vogël atje, se akrobacia ka një gjë që niset në moshë të vogël që të formosh personalitetin që ke si akrobate. Skënderi erdhi aty dhe merrte të gjitha rolet që kishin regjisorët. Pra që nga dita kur ka ardhur në 57-n dhe që që kur ka dalë në pension, Skënderit i jepeshin rolet

kryesore. Regjisori Mihallaq Luarasi e spikati këtë talent. Të gjithë regjisorët që kanë punuar në Estradë janë marrë me Skënderin në realitet, por Mihallaqi që kur hyri Skënderi aty dhe që kur e largua vetëm me Skënderin punoi. Gjithë materialet që kishte Mihallaqi ia jepte Skënderit. Ishte ky regjisor që defekton që kishte të dhëmbët Skënderi e mori pësipër që shteti t'ia rregullonte. Madje pas këtij rregullimi ia blente vetë gazetën çdo ditë që Skënderi ta lexonte me zë të lartë dhe t'i pastrohej diksioni. Plus kësaj Skënderi pati fatin të specializohej në Kinë. Në rrinë e tij ai kishte një konstrukt sportiv se ishte marrë edhe me mundje. Për dy vjet ka qenë Kampion Kombëtar në mundje. Mundjen e la, sepse shkoi për specializim për në Kinë. Ai specializim i dha atij personalitetin e madh që e ruajti deri në fund, sepse në Kinë u punua me mjeshtrit më të mëdhenj të cirkut. Mori mësim si aktor, si xhonger për cirkun, etj. Si aktor u shqua për imitimet. Ai realizoi një kolazh me cicërimat e zogjve dhe zhurmat e materialeve, të objekteve, si ajo e trenit, etj, etj. Imitonte edhe personazhe të mëdhenj, që nga Hitleri tek Hrushovi. Kishte talent për monologë e dialogë, e shumë të tjera. Skënderi edhe në cirk ishte i paarrtshëm se ka bërë edhe prestigjitorin e unë punoja me të që i sillja materialet. Ndërkohë ai punonte edhe me akrobatët. Kujtoj kur ka hipur në pedan, që hyn tek vështirësitë më të larta në akrobaci. Ishte një lisharës tek pjesa e ulur dhe ata që hidhehin lart e bënin Skënderin të fluturonte në ajër dhe ai prej këtij fluturimi hidhej me salto në karrige. Kanë qenë dy orë shfaqje akrobatike në atë periudhë, por Skënderi ka qenë me një staf që nuk i vjen kurrë kombit tonë. Ai punoi me profesorët më të mëdhenj të cirkut të gjithë Kinës. E kam kujtuar këtë kur kam shkuar para dy vjetësh me një delegacion grash. Aty jam takuar me stafin qendror të artistëve të Kinës. Mësuesja ime dhe kolege në atë kohë, se kishim të njëjtin profesion akrobate, ishte shefe e përgjithshme e Cirkut. Merr me mend se çfarë stafi pedagogësh kishim ne. Vetë Skënderi pak kohë punoi jashtë, por gjithë aktivitetin e vet e bëri në Shqipëri, ku ai krijoi pantonimat që nuk mund t'i bëjë njeri tjetër. Në Kinë kur mbaruam



Skënder e Vitore Sallaku në moshë të re

studimet, drejtori i përgjithshëm na tha "Shkoni në botë të jepni shfaqje, që ju të merrni shpërblim për talentin dhe mundin tuaj". Skënderi i tha: Nuk mundemi se kjo quhet tradhëti. Eh, kur më pyesni për Skënder Sallakun unë nuk mund të flas për të si bashkëshorte, por si artiste që di se ç'ishte vështirësia që ai e kapërcente në akrobaci e në skenë. Nuk e tepëroj të them se nga mënyra si punonte ai është një artist që nuk i vjen më kombit.

Jo, jo nuk e teproni aspak. Ju kemi shumim të drejtë, sepse cirku dhe humoristot janë në një gjendje për të ardhur keq. Zonja Vitore, si mendoni pse kishte aq shumë publik në shfaqjet e asaj kohe?

-Kishte artistë të mirë, që punonin me sinqeritet. Kujtoj se njerëzit rrinin në radhë para derës së Estradës. Biletat kanë qenë në fillim 50 lekë dhe më vonë 100 lekë.

Interesante kjo. Nëse do ta konvertonim vlerën e biletave të Estradës së Tiranës me vlerën reale të kartmonedhave të sotme i bie se ka qenë më e shtrenjtë se një biletë e operës sot, pra afër vlerës së 1000 lekëve sot?

-Po, po. Estrada nuk rrinte asnjëherë pa



Akrobatja e talentuar Vitore Rasha (Sallaku) në moshë të re

me një ndjenjë miqësie të fortë dhe vijoi me një ndjenjë dashurie që lindi natyrshëm. Ne rrinin bashkë gjithmonë edhe pa qenë të dashur, sepse dilnin në foto për shfaqjet, punonin bashkë e bisedonin për to dhe nuk u kuptua si kaloi kjo dashuri nga njëra fazë në tjetrën. Arti i ka disa gjëra të veçanta dhe dashuria jonë lindi si pasojë e një pasioni që erdhi natyrshëm. Kjo dashuri u pasqyrua gjithë jetën, derisa erdhi momenti që ne u lidhëm si bashkëshortë.

E kujton momentin kur ta ka thënë se të dashuronte?

—Në fakt s'ka pasur nevojë të ma thoshte, se lidhja jonë erdhi shumë e natyrshme dhe s'ka pasur nevojë për deklarata. Edhe unë s'jam nga ato natyra që kërkoj ose flas më tepër se ç'duhet. Madje sot po flas tepër (buzëqesh).

Lidhja erdhi vetvetiu dhe ka nisur me batutën e një numri që kishim bashkë. Unë isha në valixhe. Skënderi dilte me këtë valixhe në skenë dhe vinte si turist. Ai pyeste publikun se çfarë kishte valixhja brenda. Nuk e gjenin dot, s'e merrnin dot me mend. Kur e hapi valiçen, salla u mek nga të qeshurat. Pastaj Skënderi bëri një numër të tillë dhe tha se "që atë natë unë e mora Vitoren me valixhe në shtëpi dhe i thashë babait të kam sjellë nusen". Me një batutë të tillë, kështu nisi. Ka dashuri që nuk kanë nevojë për fjalë dhe kjo jona kështu ishte. Unë Skënderin e kam dashur shumë, por atë të gjithë e donin shumë.

Skënder Sallaku mbeti në mendjen tonë si njeriu i madh me atë buzagazin e përjetshëm. A nuk ka pasur halle e probleme ai njeri, si i sfidonte?

—Ah problemet. Ka pasur probleme me të shoqen, me mua. Mua babanë ma pushkatuan dhe vetëm se isha e talentuar dhe s'kishin akrobatë të përgatitur jashtë shtetit, me urdhër nga lart më lanë në profesion. Megjithatë me gjithë ato spiunllëqe që bëheshin nuk më linin rehat, edhe pse unë nuk ndihesha fare dhe si natyrë shihja vetëm punën. Shkonin letrat anonime në Komitetin Qendror të Partisë, sepse Skënderi ishte dhe sekretari i parë i Partisë. Merre me mend se në çfarë situatash vihej ai në atë kohë. Edhe dy faqe gazete letër anonime kishin arritur të çonin për të. Aty shkruhej se "Skënderi është sekretar partie, kur e shoqja është një artiste me babanë e pushkatuar nga Partia".

Niko Nikolla ka qenë drejtor i revistës "Hosteni", por ai ishte një burrë zotni dhe kur u bë mbledhja ka thënë: "Kush janë ata minj gjurizesh që mund të flasin për Vitoren. Kush e ka shkruar këtë letër të ngrihet e të flasë këtu. Çfarë mund të themi për Vitoren në përveçse për talentin që ka dhe të mirave që na jep".

Pra, jetën mos kujto se ne e kemi pasur fushë me lule. Por Skënderin e kam dashur sepse ai e kishte shpirtin e madh. Në atë shpirt të gjerë unë streshosheja dhe ndihesha e mbrojtur.

Përse e pushkatuan babanë tuaj. Kush ishte ai në atë kohë?

—Babai im ishte doktor profesor i diplomuar në Linguistikë, njihej si dr. Lorenc Rasha. Ai ka qenë edhe drejtor i gjimnazit të Shkodrës dhe drejtori i gjimnazit të Tiranës. Ka qenë edhe mësues i Enverit. Mirëpo në kohën e luftës babai im ishte nacionalist dhe ka shkruar edhe në Pezë për kahun që përfaqëonte. Ishte edhe mik i Myslim Pezës. Eneveri siç duket e kishte vënë në shënjestër. Ishte egoist i tmerrshëm Enveri. Një

mundëm ta gjenin. Mua, në atë kohë, pas pushkatimit të babait nuk më ngacmuan më. Unë që në moshën 10-vjeçare isha akrobate profesioniste dhe kam kërcyer në majë të telit me Ali Xhixhin. Unë nuk kisha ndonjë konkurrente dhe ma kishin nevojën, por pata edhe një mbështetje prej kësaj. Unë punoja si akrobate në fillim, por nuk paguhe-sha. Kështu që shkova në Komitetin Qendror kur ishte Ramiz Alia përgjegjës për kulturën në vitet '56, që të kërkoja të drejtën e rrogës. Duke më marrë si një copë kalama prej dore më quan tek Ramizi. Ai më tha: Po ti, moj vogëlushe, e kujt je? "Unë jam vajza e profesor doktor Lorenc Rashës", i thashë. Heshiti Ramizi një çast dhe më tha "Ik!". Unë nisa t'i thosha se jam akrobate dhe ...

"Ik, ik!", -më tha Ramizi. Kur u ktheva në punë, shefa e kuadrit më dha rrogën e dy muajve të kaluar njehershsh dhe më tha "Ta gëzosh! Nuk të luan njeri vendit".

Skënderi hyri në zmerën e popullit edhe për batutat e tij të bukura, si i kujton ato?

—Skënderi nga goja ishte i ëmbël, por edhe i hidhur në këto batutat. Dhe kjo mund ta rrezikonte nga çasti në çast. Nëse nuk do të kishte aq shumë dashuri nga publiku dhe të gjithë ata që e njihin Skënderin do ta kishte pësuar për mesazhin e tyre. Po ju tregoj një rast. Aty nga vitet '70 në Vitin e Ri do bëhej shfaqja për anëtarët Byrosë Politike. Ishte koha kur gjithë-ka na kontrollohej nga Komiteti Qendror; edhe tekstet e këngës edhe varietesë. Në këtë shfaqje pasi mbaron Skënderi tekstin e vet, salla nis t'i thoshte "Nga ato të xhepit, nga ato të xhepit" dhe Skënderi fillon, nis të tregojë:

"Në një familje po ziheshin burrë e grua për qumështin e djalit. I thotë baba djalit: -Të qoftë haram qumështi im.


-Qytja, i thotë e shoqja, çfarë harrami more burrë, unë e kam rrit me qumësht gjithë këtë djalë.

-Po unë? Harrove mojonjë që jam ngritur tërë jetën në pesë të mëngjesit me mbajt rradhë e me i marrë qumësht këtë djali."

Nuk qeshi Enveri, nuk qeshi asnjë. Ngrinë të gjithë. Një pauzë e frikshme pushtoi sallën. Skënderi me mikrofonin në dorë ngeli në një pozicion shumë të vështirë. "Mirë që nuk po haja mikrofonin", më tregonte më pas. Kur u krijua kjo pauzë kaq e thellë Enveri qeshi: -Ha, ha, ha.

Si me sustë gjithë salla u ngrit në këmbë. Shpërtheu në të qeshura të vonuara dhe duartrokite. Dhe Skënderi foli: -Shoku Enver, të mos kisha qeshur ti sonje, sa të dilja nga kjo sallë do më kishin rrasur brenda në burg ... Salla u shkri edhe njehersh së qeshuri.

Batutë e zgjaur. Njësoj sikur t'i këtë thënë se "ti Enver je tolerant çëç, e var-tësit e tu servilë..." Faleminderit për këtë intervistë, e dashur Vitore. I paharruar qoftë kujtimi i humoristit të shquar Skënder Sallaku.



Skënder Sallaku

shfaqje dhe pa spektatorët e saj në rradhë për bileta.

E ju gjithë jetën keni punuar bashkë me Skënderin. Në punë nisi dashuria juaj?

—Po, po. Si kolegë ne kemi qenë gjithmonë bashkë. Dhe ne rrinin bashkë, punonim bashkë. Po e ke parasysh profesionin tonë, në fillim nuk të shkon mendja kurrë për lidhje me partnerin. Kur je duke punuar nuk bëhet fjalë për ndonjë pëlqim personal, por bashkëpunim profesional. Të paktën mua nuk më shkante mendja. Skënderi nuk e shprehu që në fillim, por kishte nisur të më pëlqente. Në fillim ai nisi të më shoqëronte në shtëpi, duke u kujdesur të mos isha vetëm në rrugë. S'mund ta vija re menjëherë se brezi ynë ka pasur një dashuri vëllazërore, që sot pak ekziston mes të rinjve. Nuk kishte shejtanllëqe, edhe pse ne kishim një profesion që punonim edhe disi të zhveshur. Gjithçka e shihnin si pjesë të profesionit dhe të respektit për profesionin. Kështu nisi lidhja jonë dalëngadalë. Kujtoj se kur mbaram specialitetin në Kinë që na tha profesori kinez se ne ishim të aftë të jepnin shfaqje e të bridhimin botën i tha Skënderit: "E sheh këtë vajzën. Mos e lësho"... Kjo ishte si të thuash një shkëndijë, një spunto që i dha Skënderit, që tek ne nisi

ditë të bukur i thotë Myslim Peza: Mos ma prek doktorin s'e e kam mik, more vesh!". Dhe Enveri që të mos ta merrte vesh Myslymi, nuk e vrau aty, e vrau në Dajt, ku ka urdhëruar skuadrën e pushkatimit për ta ekzekutuar. Babai im ka qenë linguist i njohur me katër gjuhë me diploma të mbrojtura nga Universiteti i Innsbruket në Austri. Ishte njohës i 12 gjuhëve ndër kohë. Dhe Enveri megjithatë e pushkatoi. Trupin e babait tim e ka marrë një fshatar që e ka fshehur pas ekzekutimit, sepse e vranë dhe e lanë të zhveshur aty. Fshatari e ka tërhequr pa i dhënë askujt dhe e ka varrosur tek rrënjët e një ulliri në tokën e vet. Ne e kemi kërkuar shumë vonë dhe ky fshatar i nderuar edhe kur vdiq ia lë birin amanet vendin që ne



NGA ARBEN DUKA

HUMOR

Shqipëri kështu të desha, plot drejtorë e drejtoresha!

Gjithnjë kemi qënë,
çudi e vërtetë,
greku dhjetë ministra,
e neve njëzetë!..

T'i dijë që të gjitha,
asnjeri nuk mund,
s'i numëron dot,
drejtoritë pa fund!

Barrë për buxhetin,
janë me gjithë mënd,
nja treqind e ca,
janë në Kuvënd!

Plot njëzet ministra,
drejton një Ante,
dhe Greqia është,
katër herë sa ne!!

Fjala vjen Turizmi,
ndrin në Shqipëri,
ka veç drejtorisë,
dhe dy agjenci!

Janë në Kuvënd,
treqind e ca vetë,
dhe s'kam llogaritur,
zotrinjtë deputetë!

Në buxhetin tonë,
njëzet ministri,
s'janë një fjalë goje,
po njëzetë Lubi!

Gjer dje si ministre,
aty qe Gjermani,
po një të Përgjithshme,
përsëri e kemi!

Po më thotë Erioni,
mos i bjer shumë anës,
ka njëqind drejtorë,
Bashki e Tiranës!

Big administratën,
pa e parë me lente,
shikon për çudi,
të paktën dhjetë Ente!

E sa ka të tjera,
që emrin s'ua di,
që mba në kurriz,
mëma Shqipëri!..

Po ne jemi prapë,
çudi e vërtetë,
dhe zvendësministra,
kemi mbi dyzetë!

Ju nuk e kuptoni,
s'e kuptoj as unë,
ç'duhen tri drejtorë,
për të njëjtën punë!

Kam shkruar dikur,
për këto merraqe,
ka shumë prefektura,
po njëlloj dhe qarqe!

Përse duhen Entet,
pyes unë çdo ditë,
kur për këto punë,
kemi ministrinë?!

Big Administratë,
gjëkund nuk do gjendet,
nga pesha e saj,
shteti mund të shëmbet!


Zëvendësministra,
kemi mbi dyzetë,
ndërsa greku ka,
dhjetë dhe vetëm dhjetë!

Njëzet kabinete,
njëqind këshilltarë,
plus dhe një tridhjetë,
që Rama ka marrë!

Prefektura shumë,
po njëlloj dhe qarqe,
hanë nga taksat tona,
njëqind mijë barqe!

Entet garantojnë,
këtu "pavarsinë",
por populli njeh,
vetëm qeverinë!

Ndaj po i them Ramës,
ca ngarkesë hiqe,
sepse burokratët,
janë si tartabiq!



Homazh për Liri Jaho Gjolikun..

(Në trevjetorin e ndarjes nga jeta)

Si na ike-moj Liri Gjoliku,
se ti zëmër ishe jetëgjatë,
jetëzeza qiririn ta fiku,
ike si pëllumbe nëpër natë!

Të dy ishim tok në demonstratë,
kur me helme Saliu na mbyti,
dhe nuk bëre prapa asnjë hap,
po ndënje në ballë si shkëmb graniti!

Ndaj shikoj mos të gjej këtë,
s'më besohet se vërtet ke ikur,
se ti s'kishe gjak-po zjarr në dej,
zjarr vigan që ende s'ka të fikur!

Katër vjet më parë ne ishim tok,
në vijën e parë në demonstratë,
ti thërrisje: "Mbahuni-o shokë!..",
o zonjë fisnike-zëmërzjarrtë!

Dëshpërim i madh që më ka zënë,
se të kisha ty si një thesar,
se të kisha motër edhe nënë,
Lilo zëmra-malli më ka marrë!

Zjarr vigan që ende s'ka të fikur,
flakë e prush nëpër përvjetore,
ndaj s'them kot që ti nuk ke ikur,
Lilo Labe-Grua Madhështore!

Ti mund të jetoje fare qetë,
ta shkoje e pasur pleqërinë,
po ti kreshpëroheshe si det,
kur shihje kudo padrejtësinë!

Lilo zëmra-malli më ka marrë,
se ti je një pjesë e shpirtit tim,
sonde si fëmijë për ty kam qarë,
si fëmijë me lot e ngashërim!

Flas me ty unë-Lilo-çdo mëngjes,
shtruar edhe shtruar kuvendojmë,
në beteja-Lilo do të pres,
deri sa Atdheun ta fitojmë!

Atë kurrë s'e durove dot,
Lilo Kapedania-Lilo mira,
se të drejtës ti i dole zot,
mbase dhe në kohë më të vështira!

Po nuk vij të qaj te varri yt,
ato hapa vetes ja kursej,
se aty krejt loti do më mbytë,
ndaj shikoj-ndofta je këtë!

Kur të vijë-o Lilo-ditë e madhe,
kur e lirë të jetë vërtet kjo tokë,
kur vatani të mos ketë më halle,
Lilo Labja ikim të dy tok!



(Shënim
i autorit
Kjo baladë
ribotohet
me disa
ndryshime.
Shkruar në
SHBA më
2013 dhe në
Tiranë më 30
janar 2015)



Mateus FRROKU: Albumi, pasaporta ime artistike pas shumë vitesh

Fisnikët dhe Mateus Frroku, ngrohni publikun me "Çokollatë e shkrime"

IZAURA NDOJ
TIRANË

Pas performancës në "Top Fest", vokalisti i grupit legjendar "Fisnikët", Agim Gerguri dhe Mateus Frroku mbajnë fjalën, sjellin klipin e këngës "Çokollatë e shkrime". Në këtë rrefim mbi bashkëpunimin me "Fisnikët", këngëtarë i cili tashmë njihet për performancat e tij 'live', tregon arsyen e realizimit të videoklipit, lidhjen e tij me muzikën, sidomos me publikun e që e ndjek çdo fundjavë, por edhe projektet gjatë këtij viti.

Mbrëmë sollët edhe surprizën e rad-

Fabula

Kënga "Çokollata e shkrime" është frymëzuar nga një vajzë e bukur... të cilës i kushtohet e gjithë kënga. Është zgjedhur ky krahasim për efektin pozitiv që ka kjo fjalë në momentin e parë



më jep shumë kënaqësi dhe kërenari në të njëjtën kohë, pasi vij në një bashkëpunim me grupin legjendar "Fisnikët". Kështu që, vendosa të investoj edhe në këtë videoklip për të dhënë atë që meriton këtij projekt.

Cila është fabula e "Çokollatës"?

Kënga "Çokollata e shkrime" është frymëzuar nga një vajzë e bukur... të cilës i kushtohet e gjithë kënga. Është zgjedhur ky krahasim për efektin pozitiv që ka kjo fjalë në momentin e parë. Sigurisht, që ka plot vajza si "Çokollata të shkrime"...

Ju jeni përkushtuar më shumë muzikës "live" sesa videoklipeve. Pse kjo zgjedhje?

Muzikën 'live' e dua... kjo më bën të jemë gjithmonë në kontakt me atë që ndjekin muzikën time. Produksionet e mija shpesh kanë munguar edhe për faktin se e kam të vështirë të vendos kur bëhet fjalë për këngët e mija personale. Mendoj se çdo gjë ka rrjedh natyrshëm, pa sforcime për arritje.

Tregu muzikor është pushtuar nga muzika komerciale, mendoni se audienca duhet të vlerësojë më shumë interpretimin 'live'?

Sigurisht që njerëzit duhet ti njohin këngëtarët, sidomos të muzikës 'live'. Ndodh, që disa artistë shprehen më mirë kur këndojnë 'live' dhe japin maksimumin e tyre përball publikut, sesa kur janë në studio. Në Tiranë ka mjaftë lokale dhe ambiente ku luhet muzikë e mirfilltë 'live' dhe për fat janë plot me publik, që do të thotë se muzika 'live' nuk humbet asnjëherë, por çdo ditë dhe më shumë vlerësohet.

Kush mendon se të selekton në tregun muzikor?

Kur një këngë është e mirë e dashuron menjëherë, është e kot të lodhesh. Fatmirësisht kemi këngë të mira në treg, por ka dhe "artistë" që abuzojnë me publikun. Besoj se çdo gjë është kalimtare. Kënga e mirë është ajo që mbetet, duke krijuar edhe imazhin e artistit që e këndon.

Çfarë do të sjell ky vit për Mateusin?

Punë, studio, lëvizje dhe projekte të reja. Pak a shumë angazhimet që kam patur gjatë këtyre viteve, por me ndryshimin e vetëm tani, jemi më të rritur profesionalisht dhe më i qartë në idetë e mija përse i përket muzikës. Besoj se, do të jetë një vit i ngarkuar, me lëvizje kuptohet, gjithmonë në fokus muzikën 'live' sepse në fund të fundit kjo është ajo që më pëlqen të bëj në jetën time.

Në projektet tuaja do të ketë një album?

Nuk besoj se do të përqëndrohem në krijimin e një albumi, mbase për mua është ende shpejt. Nuk bëj pjesë tek ata këngëtarë që e shikojnë albumin si mënyrën më të mirë për të hyrë në treg. Albumin e shikoj si një pasaportë të mirë artistike pas shumë vitesh punë.



hës, videoklipin tuaj më të ri "Çokollatë e shkrime". Si lindi ideja për ta sjell në klip?

Kënga "Çokollata e shkrime", vjen si produksion u Gent Myftarajt i cili ka bërë muzikën dhe orkestrimin e këngës. Ndërsa, teksti është shkruar nga Agim Gerguri, vokalisti i grupit "Fisnikët".

Pse zgjodhët pikërisht grupin "Fisnikët". Ku qëndron e veçanta e këtij bashkëpunimi?

I gjithë ky është një projekt që mua

Kalendari Kulturor

TEATRIT KOMBËTAR EKSPERIMENTAL "KUJTIM SPAHIVOGLI"

- "Elektra", tragjedia e kimit dhe ndëshkimit brenda familjes, tragjedia e mëkatit të etërve dhe ndëshkimit të bijve do të ngjitet në skenën e Teatrit Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli" në Tiranë. Pas premierës në teatrin "Aleksandër Moisiu" në Durrës, e pas shfaqjeve të suksesshme në Korçë kjo tragjedi do të shfaqet për publikun e kryeqytetit në datë 30, 31 janar dhe 01 shkurt ora 19:00. "Elektra" kësaj here vjen nën regjinë e Laert Vasilit dhe në lojën e trupës së teatrit Aleksandër Moisiu, Durrës, ku veç domethënies artistike, një rëndësi e madhe i është kushtuar edhe lëvizjes fizike të aktorëve. Shfaqja nuk ka skenografi. Janë trupat e aktorëve, psikofiziku i tyre, lëvizjet skenike, të cilët bëjnë që të mos ndihet nevoja e skenografisë.



PROGRAMI I FILMAVE NE RRJETIN IMPERIAL PER DT 29.01.2015 - 04.02.2015

SALLA 1

- "Mortdecai" 2D / 13:00 / 20:30 / Çmimi 500 Leke
- "Asterix Le Domaine Des Dieux" 3D / 10:30 / Çmimi 500 Leke
- "Amanet" 2D / 22:15 / Çmimi 500 Leke
- "Taken 3" 2D / 18:00 / Çmimi 500 Leke
- "Big Hero 6" 3D / 15:30 / Çmimi 500 Leke

SALLA 2

- "Mortdecai" 2D / 19:00 / Çmimi 500 Leke
- "Amanet" 2D / 17:00 / Çmimi 500 Leke
- "The Wedding Ringer" 2D / 15:00 / 21:00 / Çmimi 500 Leke
- "Taken 3" 2D / 13:00 / Çmimi 500 Leke
- "Big Hero 6" 3D / 11:00 / Çmimi 500 Leke

KINEMA AGIMI

- "Mortdecai" 2D / 17:30 / 22:00 / Çmimi 500 Leke
- "Asterix Le Domaine Des Dieux" 3D / 15:00 / Çmimi 500 Leke
- "The Wedding Ringer" 2D / 12:30 / 20:00 / Çmimi 500 Leke
- "Big Hero 6" 3D / 10:00 / Çmimi 500 Leke

PREMIERE BOTORE DT. 05.02.2015

- 1- Foxcatcher 2D
- 2- Jupiter Ascending 3D
- 3- Un' insolita Vendemmia 2D

Ndikumana i dhuron fitoren e kryesimin Tiranës, sot Partizani

Lojë e bukur dhe me shumë grindë në 'Elbasan Arena' në fund bardheblutë e Maganit marrin tre pikët e plota



1

Humbje

Ka pësuar Partizani përballë ekipit të Apolonisë në fazën e parë në stadiumin "Loni Papuçiu" me rezultat 1-0. Trajneri Duro kërkon fitoren në Fier.



Shifrat



3

Gola

Ka shënuar sulmuesi i Tiranës, Ndikumana në dy ndeshjet e fundit, dy me Apoloninë dhe një përballë Flamurtarit duke i dhënë ekipit 6 pikë



41

Pikë

Ka grumbulluar Tirana në 20 ndeshjet e zhvilluara, po aq sa edhe Kukësi duke ndarë kreun në pikë të barabarta, sot prite reagimi i nënkampionëve



25

Pikë

Ka Flamurtari në vendin e 6 të renditjes duke qenë shumë larg objektivave që është zona e Europës, pasi titulli kampion u harrua përfundimisht.

DYLBER BALLA
TIRANE

Tirana fiton përballë Flamurtarit në Elbasan dhe ngjitet në vendin e parë në kampionatin kombëtar të futbollit mes 41 pikë, po aq sa ka edhe Kukësi, por nënkampionët kanë një ndeshje më pak. Megjithatë deri të shtunën Tirana ndan vendin e parë me verilindorët. Ndeshja në "Elbasan Arena" ishte e fortë dhe me shumë ritëm nga të dy ekipet që kërkonin fitoren me çdo kusht si alternativën e vetme. Pjesa e parë ishte e mbushur me shumë raste, por për t'u theksuar vlen ai i Bakajt në të 42' ku mesfushori kishte mundësinë për të kaluar bardheblutë në avantazh i vetëm përballë portierit Lika, por goditja u devijua nga këndi. Në pjesën e dytë Flamurtari e nis akoma me më shumë ritëm duke kërkuar golin në disa mënyra, por pa arritur që të finalizojë, ndërsa Tirana godet edhe një shtyllë duke iu afruar avantazhit. Kur dy ekipet po i drejtoheshin fundit të sfidës, në 5' e fundit shënon sulmuesi Ndikumana duke i dhënë Tiranës një tjetër fitore me vlera pas asaj me Apoloninë një javë më parë.

DEKLARATAT

Trajneri i ekipit të Tiranës ka mbetur i kënaqur pas fitores ndaj Flamurtarit në 'Elbasan Arena'. "Ekipi në pjesën e parë nuk funksionoi, pasi nuk ishte agresiv para portës, ndërsa në pjesën e dytë ndryshoi. Ishte një fitore e vështirë, por e bukur. Shpresoj që të vazhdojmë në këtë rrugë edhe në ndeshjet në vazhdim, pasi fazën e tretë e kemi nisur sipas parashikimeve" tha ai. Në krahun tjetër tekniku italian që drejton kuqezinjët, Ramella mbeti i zhgënjyer me këtë rezultat, pasi sipas tij, ekipi meritonte më shumë nisur nga ajo që tregoi në fushë. "Loja ishte e mirë, rezultati jo. Jam i kënaqur me atë që djemtë bënë në fushë, pasi patëm disa raste për shënim. Nëse do të ishim treguar më të saktë mund të kishim marrë tre pikët" deklaroi ai. Ndërsa për penalltinë e pretenduar në fund nga Flamurtari, Ramella thotë se "Doja të përgëzoja gjyqtarin sepse ishte shumë i aftë. Mori një vendim në një fraksion sekonde dhe në të tilla raste mund të akordohet ose

Superiorja	
Dje	
Tirana-Flamurtari	1-0
Sot	
Teuta-Vllaznia	14:00
Skënderbeu-Laçi	14:00
Kukësi-Elbasani	14:00
Apolonia-Partizani	17:00

jo penalltia. Ai vendosi për jo, gjykimi i tij ishte i përsosur" përfundoi italianin.

PARTIZANI

Partizani sot udhëton për në Fier, teksa përballë do të ketë Apoloninë, e cila këtë edicion i shkaktoi humbjen e parë në stadiumin "Loni Papuçiu" me rezultat 1-0. Por nga fillimi i edicionit gjërat kanë ndryshuar shumë për Partizani. "Synimi është mar-

rja e tre pikëve. Fieri po tregon rritje në lojë dhe çdokush që do përballët nuk do ta ketë të lehtë t'i marrë pikë. Ecuria e ekipeve të tjera nuk na intereson, por ne duhet të shohim vazhdimësinë. Rreziku për tolerim nga ana e ekipeve që mund të bien nga kategoria ekziston dhe është e pa shmangshme, por shpresoj që mos të ketë të tilla lëshime. Dëshira për një sulmues të mirë qëndron por koha e shkurtër në dispozicion" deklaroi ai.



Kryeprokurori Besnik Cani

VLLAZNIA-KUKËSI

Nisin hetimet për 2 kallëzimet, Cani: Dosjet do bashkohen

Kryeprokurori Besnik Cani sqaron për "Shqiptarja.com" hetimet për trukimin

Kryeprokurori i Shkodrës, Besnik Cani në një prononcim për gazetën "Shqiptarja.com" sqaron procedurën që po ndiqet për hetimin e ndeshjes Vllaznia-Kukësi, e cila dyshohet se është e trukuar. Për sfidën e javës së 19-të janë depozituar 2 kallëzime penale nga klubi i Vllaznisë për hetimin e ndeshjes dhe nga Kukësi që akuzon këshilltarin Bashkiak të Shkodrës, Erogen Vaso për shpifje. Vaso akuzonte se ndeshja ishte e trukuar dhe se Kukësi i kishte dhënë 100 mijë Euro Vllaznisë me qëllim që të toleronte të 4 ndeshjet e kampionatit. Prokurori Besnik Cani

shpreh se dy kallëzimet do të bashkohen në një dosje të vetme. "Hetimi për ndeshjen Vllaznia-Kukësi pas kallëzimeve ka nisur. Kallëzimi i drejtuesve të ekipit të Vllaznisë për hetim të ndeshjes, por edhe i drejtuesve të Kukësit për shpifje ndaj Erogen Vasos do të bashkohen në një dosje. Prokurori që ka marrë në ngarkim çështjen ka nisur hetimet për të zbardhur të vërtetën, prandaj nuk mund të them asgjë më shumë për mediat" deklaroi ai. Hetimi i prokurorisë së Shkodrës pritet që të nisë nga kontrolli i tabulateve telefonike të lojtarëve dhe drejtuesve. Pjesë e hetimit do të jenë edhe lëvizjet dhe shumat e luajtura në kompanitë e basteve për ndeshjen në fjalë dhe mbi të gjitha deklaratat e protagonistëve. Erogen Vaso ishte i pari që denoncoi përmes Facebook duke akuzuar se ndeshja ishte e shitur dhe pritet që të japë dëshmitë e tij në lidhje me informacionin. Kujtojmë që ndeshja Vllaznia-Kukësi përfundoi me rezultat 2-1.

Shkurt

ANGLI

Diego Costa pezullohet 3 ndeshje, humbet City-n

Sulmuesi i Chelseas Diego Costa është dënuar me tre ndeshje pezullim pas shkeljes së mbrojtësit të Liverpoolit, Emre Can në duelin e mesjavës në 'Stamford Bridge' e vlefshme për kualifikimin në finalen e Capital One Cup. Sulmuesi do të mungojë në tri ndeshje duke filluar nga dueli me rivalin për titull, Manchester City të shtunën në Stamford Bridge, e cila është e rëndësishme.



BUNDESLIGA

Bayern Muni me pushime Wolfsburgu i bën poker

E pabesueshme, por e vërtetë, Wolfsburgu shkatërron Bayernin e Mynihut me rezultat 4-1. Vendasit e nisën ndeshjen mjaft mirë, pasi shënuan me Bas Dost në të 4' dhe 45'. Në pjesën e dytë trefishoi Kevin de Bruyne 53', ndërsa Juan Bernat 55' ngushtoi shifrat, por vetëm kaq, pasi për golin e katërt mendoi përsëri Kevin de Bruyne.

LAJME

nga botë

Ministri: Greqia nuk bashkëpunon më me Trojkën

— Greqia nuk ka ndërmend të negociojë kushtet e borxhit të saj me Trojkën. Qëndrimi i prerë i qeverisë së re të Athinës u bë dje publik nga ministri grek i financave Yanis Varoufakis pas takimit me kreun e Eurogrup Jeroen Dijsselbloem. Varoufakis tha se Greqia nuk do të negociojë me BE dhe FMN-në por se kërkon bisedime të drejtpërdrejta me liderët e eurozonës në përpjekje për të anuluar më shumë se gjysmën e borxhit të saj. Dijsselbloem paralajmëroi Greqinë të mos ndërmarrë veprime të njëanshme që s'do sjellin asnjë zhvillim. Sipas tij qeveria e re greke nuk duhet të hedhë në erë gjithçka është arritur në vitet e fundit dhe duhet t'i përmbahet angazhimeve për reforma. Ndërkohë Ministri gjerman i financave Schaeuble, tha se nuk do lejojë askënd të shantazhojë duke theksuar kështu JO-në e prerë të Berlinit ndaj një kërkesë të qeverisë së Tsipras për reduktimin e borxhit grek.

ISIS, Johnson: Ekstremistët të refuzuar nga gratë

— Boris Johnson kryebashkiaku i Londras ka akuzuar hedhur një sërë akuzash kundër luftëtarëve të ISIS duke i fyer ata. Në një intervistë për The Sun ai tha se të gjithë burrat që udhëtojnë drejt ISIS për tu bërë ekstremistë, e bëjnë këtë pasi janë të refuzuar nga gratë e tyre dhe e kanë kaluar të gjithë kohën duke parë filma pornografikë. Deklarata e Johnson është bërë pasi ai ka marrë në dorëzim një raport të MI5 mbi profilin tipik të terroristëve. "Nëse ju shikoni në të gjitha profilizimet psikologjike, kamikazët zakonisht shohin pomografi."

Presidenti i ri i Italisë, dështon raundi i tretë

— Dështon edhe raundi i tretë i zgjedhjeve të Presidentit të ri në Itali, ku edhe në votimin e bërë ditën e sotme, asnjë prej kandidatëve nuk ka arritur të sigurojë 2/3 e votave. Edhe në raundin e tretë Sergio Mattarella, kandidati i propozuar nga Kryeministri Matteo Renzi, nuk ka arritur të marrë shumën prej 673 votash, e nevojshme për t'u zgjedhur në krye të shtetit italian. Ashtu si dy ditë më parë edhe dje kanë dominuar votat e bardha, ku në votimin e sotëm janë shënuar plot 531 të tilla.

RREZE DIELLI

ÇDO DITË
nga e hëna
në të premte
Ora 7.30 - 11.00
në televizionin
A1 REPORT!

ME ZNJ. TEFTA
me recetat e gatimit
më të veçanta

ENEIDA
me të ftuarit më special

Alba Malltezi - Drejtore e Përgjithshme e Free and Fair Media Group ; Aurel Pepa - Zv/kryeredaktor
Genc Kondi - Administrator i Përgjithshëm; Admirina Peçi - Kryeredaktore e "Rilindasi"; Politika: Juxhin Mustafaraj; Ekonomi: Lorenc Rabeta; Aktualitet: Elton Qyno ;
Socialia: Sonila Isaku; Kulturë: Dhurata Hamzai; Sporti: Dylber Balla; Design: Altin Allaj, Erjon Ymeri; Website: Greta Malaj; Shpërndarja: Spiro Meshini cel: +355696008847

Departamenti i Marketingut:
Vera Përleka
Cel: +355696060419
marketing@shqiptarja.com

Redaksia: Rruga: "Dervish Hima" tre kullat, kulla e dytë-Tiranë. E-mail: redaksia@shqiptarja.com - Website: www.shqiptarja.com - Mobile: +355696060421 - Shtypur në shtypshkronjën: KLASS shpk, Rruga 5 Maji, Tiranë